

NDERVEPRIMI ME MJEDISIN

Shfrytezimit i Mineralit te Kromit

Vendburimi “Fushe lope” Letaj, Kraste, Martanesh Bulqize, Diber

Raporti u hartua ne baze te Ligjit 10 440, date: 07.07.2011, “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, Shtojca II, Industri nxjerrëse. Pika 2.1 Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës (projekte që nuk janë përfshirë në shtojcën I) dhe pika 2.2 Miniera nentokesore, pasi kemi shfrytezim nentokesor dhe siperfaqesor.

Por duke qene se kemi te bejme me ndryshim te projektit ekzistues i referohemi nenit 8, pika 1/b e ligjit nr. 10440/2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis » te ndryshuar

Neni 9: Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis - projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure.

Vendimi i AKM per VNM te Thelluar, AN090620200002, date 27.07.2020

PASQYRA E LENDES:

I. HYRJE

II. PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE DHE PROCESIVE QE DO TE SHTOHEN NE IMPJANTIN EKZISTUES

III. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

IV. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

V. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE

VI. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

VII. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

**VIII. I
INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE
NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA**

**IX. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE
NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS**

X. REHABILITIMIT I MJEDISIT TE NDIKUAR

**XI. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E
NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

XII. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR

XIII.

P

**LANI I MENAXHIMIT DHE PROGRAMI I MONITORIMIT TE
MJEDISIT**

XIV.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

I. HYRJE

Projekti i hartuar ka per qellim shqyrtimin e mundesise se vazhdimit te shfrytezimit te objektit te mineralit te kromit ne vendburimin "Fushe lope" Letaj nga subjekti privat "DELIU 3D"sh.p.k i regjistruar ne QKB, i cili eshte zoterues i lejes minerare te shfrytezimit Nr 1855, date 27.04. 2018

Kerkesa per ndryshimin e koordinatave te kesaj leje eshte bere ne zbatim te VKM Nr 218. date 11.03.2015 " Per percaktimin e kriterëve procedurave dhe rregullave per shfrytezimin, ne siperfaqe dhe nentoke, te zonave qe jane ngjitur me lejet ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave per lejet minerare te percaktuara ne hapsire me tri koordinata"

Mbas kerkeses se subjektit Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, me shkresen Nr 15540 Prot, date 28.12.2018, ne zbatim te VKM Nr 218 , date 11.03.2015 ka miratuar paraprakisht fillimin e procedures per zgjerimin e lejes minerare Nr 1855, date 27.04.2018

Projekti per zhvillimin e veprimtarise minerare dhe programin e investimeve, ka per qellim shqyrtimin e mundesise se shfrytezimit te mineralit te kromit ne objektin "Fushe Lope", Letaj, Njesia Administrative Martanesh, rrethi Bulqize, qarku Diber nga subjekti "DELIU 3D" Sh.p.k, i rregjistruar ne QKB, me nipt L36901401V. Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis hartohet me kerkesë te administratorit te subjektit "DELIU 3D", Z. Eduard DELIU.

Vendndodhja e objektit

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Objekti i kromit “Letaj” vendburimi “Fushe Lope” pjese e lejes minerare Nr 1855, date 27.04.2018

Objekti lidhet me rrugen automobilistike nacionale Bulqize - Kraste nepermjet degezimit djathtas me rrugen per tek objekti Fushe Lope, Letaj, Kraste, Martanesh etj., si dhe nepermjet rruges qe lidh kete objekt me minieren e Theknes. Objekti i kerkuar per zgjerimin e lejes minerare te shfrytezimit te kromit nr 1855 ndodhet ne ndarjen administrative te rrethi Bulqize, Qarku Diber.

Objekti i kromit “Fushe Lope”, Letaj ndodhet ne afersi te fshatit Kraste, Martanesh ne juge perendim te tij, eshte pjeserisht i studjuar nga sherbimi gjeologjik, por per natyren e trupave, zbulimi me efikas, do te ishte zbulim dhe shfrytezim i tij. Ne afersi te objektit jane shfrytezuar pjeserisht vendburimet e kromit Kraste, Martanesh, etj..


Objekti i kromit “Fushe Lope”, Letaj ben pjese ne zonen Lindore malore, ne lartesine mesatare + 900 m deri ne +1100 m mbi nivelin e detit. Qendra me e banuar me e afert eshte fshati Kraste, Martanesh, me rreth 1000-1500 banore, i cili ndodhet ne vije ajrore rreth 2.5 km me ne Verilindje te objektit. Objekti ndodhet ne planshetin me nomenklature K-34-89-C-b te shkalles 1:25 000.

KOORDINATAT E LEJES MINERARE Nr.1855/1								
Nr.	X	Y	Nr.	X	Y	Nr.	X	Y
1	45 88 205	44 35 397	13	45 88 500	44 35 650	26	45 87 650	44 36 150
2	45 88 320	44 35 189	14	45 88 420	44 35 650	27	45 87 650	44 35 654
3	45 88 438	44 35 190	15	45 88 420	44 35 680	28	45 87 492	44 35 653
4	45 88 435	44 35 375	16	45 88 449	44 35 696	29	45 87 492	44 35 726
5	45 88 590	44 35 376	17	45 88 439	44 35 704	30	45 87 411	44 35 726
6	45 88 590	44 35 560	18	45 88 333	44 35 655	31	45 87 411	44 35 587
7	45 88 500	44 35 560	19	45 88 149	44 35 973	32	45 87 492	44 35 587
8	45 88 281	44 35 591	20	45 88 250	44 36 424	33	45 87 492	44 35 649
9	45 88 257	44 35 639	21	45 88 401	44 36 424	34	45 87 650	44 35 650
10	45 88 300	44 35 640	22	45 88 661	44 36 684	35	45 87 650	44 35 400
11	45 88 300	44 35 610	23	45 88 727	44 37 115	Siperfaqja e Lejes Nr.1855/1 = 0.958 km ²		
12	45 88 500	44 35 589	24	45 88 130	44 36 675			
Siperfaqja Leja 1855 = 0.480 km ²			25	45 87 994	44 36 659			

Tabela Nr 1 Koordinatat e pikave qe kufizojne zonen e shfrytezimit te lejes 1855 se bashku me zgjerimin.

Siperfaqja e zones se lejes minerare te shfrytezimit Nr 1855 eshte 0.48 km² se bashku me zgjerimin e saj behet 0.958 km²

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”



II. PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE DHE PROCESEVE QE ZHVILLOHEN

Objekti i zones ndertohet nga nje trup xeherori me forme gjeosinklinali qe do te shfrytezohet gradualisht me te dy menytrat, si me qiell te bapur, per pjeset prane siperfaqes ashtu edhe me nentoke, kryesisht me sistemin me galeri nenkati. Puna do te fillohet njekoheisht me te dy variantet, mbasi kushtet e vendosjes se mineralizimit e lejojne kete menyre.

Zgjedhja e sistemit te shfrytezimit eshte kompleksiteti i punimeve te hapjes, pergatitjes, zbulimit dhe shfrytezimit te mineralit sipas nje programi pa rrezik per jeten e njerzve. Per zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh keto elemente:

- Elementet e trupit xeheror strashesia, kendi , pozicioni i tij lidhur me punimet e hapura;
- Qendrueshmëria e mineralit dhe e shkembjeve rrethues
- Eksperienca e fituar ne shfrytezimin e trupave xeheore te kromit ne vite ne miniera.

Duke u mbeshtetur ne kushtet e vendodhjes te trupit xeheror te kromit, ku kendi i renies se tij luhetet ne kufijte e 65 - 70° dhe ne drejtim te kundert ne renien e terenit, sistemi i shfrytezimit me I pershtatshem nga ana teknike e ekonomike eshte:

Per pjesen me dalje siperfaqesore dhe prane siperfaqes sistemi i shfrytezimit me punime siperfaqesore, me qiell te hapur-karrjere.

Per pjesen me ne thellesi sipas renies se trupit, sistemi klasik I shfrytezimit me "galeri nenkati".

Te dy sistemet, si ai me qiell te hapur-karrjere dhe galeri nenkati, garantojne nje pune norrnale ne miniere, si dhe humbjet e xehrorit gjate pergatitjes e shfryteziimit jane ne nivele te ulta. Nga eksperienca ne minierat e kromit te vendit tone ka rezultuar se kjo humbje shkon ne kufijte 10+12%.

Sistemi i zgjedhur I shfrytezimit me punime siperfaqesore, me qiell te hapur-karriere siguron:

- Nxjerrjen ne volum e cilesi te mineralit qe kerkohet per tu prodhuar ne dite, muaj, e vite me leverdi ekonomike e siguri maksimale ne pune
- Efektivitet te larte te shfrytezimit te objektit dhe percakton tipin e mjetit

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

te ngarkimit, transportit, permasat e karrieres, elementet kryesore gjeometrike, si dhe treguesit tekniko -ekonomik te punes ne karriere.

Ne zgjedhjen e menyres se shfrytezimit me qiell te hapur-kanjere, ushtrojne ndikimin e tyre faktoret e meposhtem:

- Kushtet tekniko minerare;
- Menyra e kryerjes se punimeve ne zbulimin dhe prodhim, menyra e ngarkimit, transportit te mineralit dhe sterilit, si dhe depozitimit te tij;
- Mjetet e ngarkimit qe parashikohen te perdoren ne zbulim dhe prodhim;
- Menyra e rrezimit te mineralit;

Sistemi i zgjedhur i shfrytezimit me punime nentokesore me aplikimin e sistemit me galeri nenkati kerkon punimet minerare te cilat jane:

Galeria e ajrimit dhe e transportit, ku lartesia ne vertikalitet nuk duhet te kaloje 40m

Oxhaqet ose remontet te cilat hapen nga poshte lart neper trupin e kromit ose shkembinj rrethues. Keto punime fillimisht hapen nga rruga kryesore e transportit ne distance ne plan 6+8m dhe kur arrijne ne lartesine e nenkatit te pare lidhen njeri me tjetrin ku sipas kushteve konkrete njeri sherben si rruge kalimi ndersa tjetri si punim transporti per gravitet ose si bunker.

Sipas kesaj rradhe pune vazhdohet ne nenkatet e mesiperme deri ne lidhjen e tyre me galerine e ajrimit ose siperfaqen. Seksioni i punimeve te pjerrta ose vertikale ne hapje, luhetet 2,2-2,56 m dhe armatosen gjate gjithe gjatesise se tyre. Punimet e nenkateve jane punime horizontale qe ndjekin trupin e kromit ne shtrirje, seksioni i tyre ne hapje luhetet 3.6 - 4m dhe ne zonat e caktuara ku formacionet jane te paqendrueshme keto armatosen. Lartesia ne vertikalitet midis nenkateve do te jete nga 6-8 m Punimet e prerjes ne pergjithesi jane punimet e pjerrta sipas renies se trupit te kromit dhe hapen ne kufijet fundore te bllokut ose ne qender te tij, nga ku fillon shfrytezimin i bllokut. Ne minierat e vendit tone jane perdorur me sukses sipas rastit variantet e sistemit te shfrytezimit me galeri nenkati me hapsira te hapura. Me poshte po japim variantin me te perdorshem si dhe treguesit tekniko-ekonomik te tij:

Varianti pa horizont copetimi.: (Ngarkimi behet me krahe)

Treguesit e ketij varianti jane:

1.Permasat e bllokut

50x40m

2.Prodhimtaria ditore

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

	40-50tdite
3.Prodhimtaria mujore	1200-1500t/muaj
4.Metrazhi specifik i punimeve horizontale ne steril dhe ne mineral 18ml/1000ton	16-
5. Metrazhi specifik i punimeve te pjerrta ne steril dhe ne mineral 16ml/1000ton	15-
6.Rendimenti per punetor pune	3-4 ton/dite
7.Humbjet gjate shfrytezimit	15-16%
8.Varferimi i mineralit	9-10%
9.Konsumi i lendes plasese ne avancimin e galerive	1,5-2kg/m3
10. Konsumi i lendes plasese ne rrezimin e mineralit	0,3-0,35kg/m3
11. Konsumi i lendes se drurit ne prodhim	6- 7m3/1000ton

Mbeshtetur ne sa me siper sistemi i shfrytezimit qe do te perdoret ne objektin "Fushe Lope", Letaj do te jete ai i kombinuar, me qiell te hapur-kantjere me transport, per pjesen e siperme afer siperfaqes dhe me nentoke, me galeri nenkati, me hapesira te hapura, per pjesen me ne thellesi te renies se trupit xeheror.

Sistemin e shfrytezimit me qiell te bapur-karrjere me transport

Sistemin e shfrytezimit me qiell te hapur-karrjere me transport eshte universal pasi pershtetet me shtrirjen e vendburimrt, relievin e siperfaqes, si dhe me fortesine dhe qendrueshmerine e shkembinjve.

Sterili qe do te dale nga punimet e zbulimit do te ngarkohet ne automjet me ane te mjetit te ngarkimit dhe do te transportohet ne vend depozitimet brenda kufijve te zones.

Shfrytezimi parashikon fillimin e punimeve nga lart-poshte. Kjo menyre shfrytezimi lejon zhvillimin normal te punimeve te shfrytezimit duke krijuar siguri ne pune si dhe krijon mundesi per shfrytezim te njekoheshem ne disa shkalle.

Elementet e sistemimit te shfrytezimit

- Lartesia e shkalles se karrieres 10m;
- Lartesia e nenshkalles se karrieres 2 - 5m;

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Gjeresia e sheshit te punes nga 8-12 m ne 20-40m;
- Kendi i skarpates se shkalles 67- 70%
- Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve 3m;
- Kapaciteti ditor deri 20 ton ne dite;
- Bartja dhe transporti I mekanizuar;
- Rrezimi i zbulimit dhe mineralit mekanikisht me perdorimin e (9ekil;; rre:mes) koves se ekskavatorit, si dhe me perdorimin e lendes plasese

Lartesia e shkalleve

Lartesia e shkalleve eshte pershtatur duke marre ne konsiderate:

- Sigurine ne pune
- Vetite fiziko - mekanike te shkembinjve.
- Menyren e shkeputjes se shkembit nga masivi
- Tipin e mjetit te ngarkimit

Ne ndertimin e karrierave ne shpate mali te pjerreta dhe shume te pjerreta, eshte pranuar lartesia optimale e shkalles 10 m, e cila siguron rendiment te larte te mjetit te ngarkimit dhe siguri nga rreshqitja e shpateve te shkalleve.

Kendi i skarpatave te shkalleve

Ne percaktimi e kendit te skarpates se shkalleve dhe transheve te hyrjes ne cdo shkalle dhe shesh pune te karrieres jane marre parasysh tregues te tille si:

Sistemi i carjeve, shtresezimi dhe orientimi i tyre ne raport me pozicionin dhe kendin e orientimit te shkalleve dhe shesheve te karrieres, treguesit gjeomekanike dhe fiziko - mekanike te shkembinjve dhe eksperienca e shfrytezimit ne karrierat analoge.


Sistemin e shfrytezimit me galeri nenkate, me hapësira te hapura;

Elementet e tjere te ketij sistemi jane:

- Lartesia e katit 30-40 m
- Lartesia e nenkatit 6-8 m
- Seksioni I nenkateve 3.6m²
- Largesia midis hinkav 6-8m
- Gjatesia e traversave te hinkave 2.5-3 m
- Seksioni i oxhaqeve te hinkave 2.25 m²


Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Gjatesia e bllokut 40-50m (ne varesi te shtrirjes, dhe tektonikave)
- Transporti i mineralit ne frontin e shfrytezimit per gravitet
- Rrezimi i mineralit ne shfrytezim me L.E
- Diametri i birave 38-42 mm
- Gjatesia e bires ne rrezim nga 1-15 deri 3-4 m
- Trashesia e trupit xeheror 0.6-1.8 m
- Pjerresia e trupit xeheror 65-70°



Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Skematikisht sistemi i shfrytezimit paraqitet si me poshte :



Pershkrimi proceseve te seleksionimit , thyerjes, fraksionimit, pasurimit apo metoda te tjera qe do te perdoren per perpunimin e mineralit dhe realizimin e produkteve te parashikuara, sipas granulometrise se tyre skemat perkatese teknologjike dhe treguesit

Gjate punimeve te shfrytezimit krahas prodhimit te mineralit te kromit do te kemi perzierje te mineralit me copa shkembijnsh qe dalin gjate procesit te rrezimit dhe hapjes se punimeve te kerkimit per trupin e mineralizuar. Per kete qellim ne objekt do te parashikohet edhe procesi i seleksionimit i cili do te kryhet ne siperfaqe, duke larguar ne menyre mekanike heqjen e gureve me dore. Seleksionimi I minerali do te behet direkt ne frontin e punes. Shfrytezimi do te jete i kombinuar me qiell te hapur-kantjere me transport per pjesen e siperme afer siperfuqes, dhe me nentoke me galeri nenkati, me hapësira te hapura varianti i pare, per pjesen me ne thellesi te renies se trupit, duke ruajtur ne pergjithesi elementet e sistemeve te shfrytezimit qe cituam me siper gje qe krijon mundesine e seleksionimit direkt ne frontin e punes Gjate avancimit te punimeve te pergatitjes, sic jane galerite e bllokut e te nenkati, do te perdoret menyra e seleksionimit. Kjo konsiston ne berjen e birave te ballit te galerive ne menyre te vazhduar dhe shperthimin e tyre ne menyre selektive. Fillimisht do te plasen birat qe jane ne mineral, do te behet heqja e mineralit nga fronti dhe pastaj do te behet plasja e birave te ballit ne steril. Kjo

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

menyre avancimi ben te mundur nxjerrjen e mineralit te kromit pa shoqerim me sterile.

Pershkrimi I programit te shfrytezimit dhe/ose perpunimit te mineraleve te propozuara

Ne baze te sasise dhe cilesise se mineralit qe kane objektet dhe menyres se shfrytezimit do te parashikohet edhe programi i shfrytezimit duke u mbeshtetur ne hapjen dhe pergatitjen e vendburimit si dhe ne planifikimin e sasise se prodhimit qe do te prodhohet per cdo vit. Prodhimi i mineralit te kromit do te filloje mbasi te jete marre leja e shfrytezimit. Mendojme qe koha e shfrytezimit te objekteve te jete deri ne 25 vjet dhe prodhimi mesatar vjetor 1000 ton. Gjate kryerjes se punimeve pergatitore do te vazhdoje edhe shfrytezimi mineralit te kromit ne pjeset qe pershkruam me siper dhe do te zbatohet nje grafik isakte per zhvillimin e punimeve pergatitore dhe te shfrytezimit.

Fillirnisht do te ndertohen rruget qe te cojne ne zonat e konkretizuara per zhvillimin e punimeve pergatitore dhe ato te shfrytezimit, si dhe do te hapet nje shesh per ndertimin e objekteve ndertimore siperfaqesore dhe ne vazhdim do te filloje zbulimi i trupit te mineralizuar sipas projektit te paraqitur per kete qellim.

III. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e çdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisit te zones ku ai zbatohet.

Qellimi i VNM-se eshte qe te siguroje qe mjedisi ne zonen ku zbatohet projekti do te konsiderohet i lidhur me gjithë çështjet e tjera te rendesishme, ne çdo etape te tij.

Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikojë, parashikojë dhe vleresojë gjithë ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja eshte vleresimi mjedisor ne nje proces vleresimesh (te mjedisit, planifikimit hapesor, ndertimit, etj.) qe eventualisht mund te finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne fakt i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyç:

- A. Si do te ishte mjedisi pa projektin?** (per shembull Studimet Baze). Kjo do te identifikojë dhe pershkruajë gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.
- B. Çfare do t'i ndodhe ne mjedisit, si pasoje e projektit?** (per shembull Parashikimi). Kjo do te pershkruajë mjedisin siç eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshojë si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- C. A perben kjo nje shqetesim?** (per shembull Vleresimi) Parashikimi i ndikimit nuk eshte i mjaftueshem.
- D. Neseeshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te?(per shembull Zbutja).** Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet diçka per teshmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t'i perfshije keto masa zbutese ne propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i perfshije kerkesat perkatese ne kushtet e lejes sedhene.

Ne menyre qe autoritetet kompetente dhe palete jashtme te interesuara te vendosin nese projekti duhet te vazhdoje, eshte thelbesore qe informacioni mjedisor i dhenenga zhvilluesi ne Raportin e VNM-se, t'i pergjigjet ne menyre te qarte pyetjeve te mesiperme. Qellimi i studimeve te VNM eshte qe te gjenerojedhe paraqesete informacion ne menyre te qarte, koherente dhe te sakte.

Idea e VNM-se eshte te siguroje informacion per vendim marresit dhe publikun mbi pasojat mjedisore te zhvillimeve te reja te propozuara. Per me teper ideja eshte qe te promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojedhe ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a. procesin paraprak te VNM-se;
- b. procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se,

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe i'a degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se

Referuar ligjit nr. 10440/2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, te ndryshuar projekti i propozuar “impiant per kompostimin e mbetjeve” listohet ne Shtojcen II te ketij ligji ne piken 11 (b) “Instalimet per asgjesimin e mbetjeve (projekte te cilat nuk perfshihen ne shtojcen I)” dhe si rrjedhoje i nenshtrohet procedures paraprake te VNM-se.

Theksojme se gjate procedures paraprake te VNM-se, referuar VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”, Kreu I **nuk eshte e detyrim ligjor te behet Konsultim Paraprak me banoret e zones.** Perprara marrjes se Vendimit (sic detajohet me poshte) AKM-ja publikon aplikimin per VNM paraprake ne eeb te saj, ku komuniteti i interesuar mund te shpreh mendimin e tij.

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimin e saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korrigjuar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.

Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose çdo autoritet pergjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a. raport paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’ te ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’ te ndryshuar.

Baza ligjore

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 ‘Per mbrojtjen e mjedisit’, te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 ‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’, te ndryshuar;
3. VKM nr. 686, date 29.07.2015 ‘Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore’;
4. **Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011“Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, te ndryshuar;**
5. VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
6. VKM nr. Nr. 608, date 17.9.2014 “Per percaktimin e masave te nevojshme per grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet per pakesimin e tyre”
7. VKM nr.175, date 19.1.2011 “Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve”
8. VKM nr. 371, date 11.06.2014 “Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
9. VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim”
10. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

11. VKM nr. 705, date 10.10.2012 “Per menaxhimin e mbetjeve te automjeteve ne fund te jetes”
12. VKM Nr. 765, date 7.11.2012 “Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”
13. VKM Nr. 866, date 4.12.2012 “Per baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre”
14. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 “Per mbrojtjen e faunes se eger”
15. Ligji nr. 81/2017 “Per zonat e mbrojtura” ;
16. Ligi nr.10 253, date 11.3.2010 “Per gjuetine”
17. Ligji nr. 68/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar.
18. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
19. VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”
20. VKM nr.519, date 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
21. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kritereve te administrimit te pyllit komunal"
22. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
23. VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
24. VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
25. VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
26. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
27. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
28. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te”.

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te perafuara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Ndikimet mjedisore te projektit vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin pergatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese nje detyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.
- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimin e efekteve te pritshme te masave te propozuara.

Aspektet me te rendesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohet nje VNM e thelluar.

VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikojte propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rendesishme, ose pak, ndikime lehtesisht te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme. Ne vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do te ndihmojne ne procesin i cili vendos nese kerkohet VNM per nje projekt te vecante ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- **Paraqitja e kerkeses** dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik **paraprak** i bere nga AKM dhe **konsultimi** i AKM **me insitucionet e tjera** dhe **publikimi** i aplikimit;
- AKM njofton per **vendimin e marre**, nese projekti eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Mjedisit (MM) dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marrveshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimitmjedisor (VNM) për projektet që mund të rezultojnë me ndikim domethënës në mjedis. VNM duhet të përgatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marre paraysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të përmbledhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi për ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga projekti i propozuar apo te kritereve kufizuese, të vendosura nga secili shtet anëtar. Propozimi aktual konsiderohet si një projekt i Shtojcës 2.

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti për:

- Qëniet njerëzore, floren dhe faunen;
- Token, ujin, klimen dhe peizazhin;
- Asetet materiale të trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër që përcaktohet në direktive që duhet të përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe të teknologjise të marra në shqyrtim për projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shume nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, token, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, clirimi/shkarkimi i lëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anetare dhe ndjek detyrimet e konventave të mëposhtme nderkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) “Per mbrojtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisin e saj natyror ne Evrope.”, miratuar me ane te ligjit nr 8690, me 2 Mars 1998;
- Konventa e Barcelones “Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujqor te Mesdheut” dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit “Mbi mbrojtjen e faunes se eger shtegtare”;
- Konventa e Vienes “Mbi kontrollin e kalimit kufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre”, miratuar me ane te ligjit nr. 8216, me 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit” dhe protokollit i Montrealit “Mbi substancat qe demtojne shtresen e Ozonit”;
- Konventa e Aarhusit “Mbi te drejten e publikut per t’u informuar, per pjesemarrje ne vendim-marrje dhe e drejta per t’iu drejtuar organeve te drejtesise per çështjet mjedisore”, miratuar me ligjin nr. 8672, me 26 Tetor 2000;
- Konventa “Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne kuadrin Nderkombetar”. Hyr ne fuqi ne 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara “Konventa kunder zgjerimit te shkretetirave ne vendet e thata, veçanerisht ne Afrike”. Hyrja ne fuqi me 27 Prill 2000.

Perfitimet e procesit te V. N. M. jane:

- Reduktimi i kohes dhe kosos se zbatimit te projektit;
- Modifikimi i projektit ne fazen e projektimit ndihmon ne reduktimin e kosos;
- Parandalimi i ndikimit ne mjedis dhe thyerjeve te ligjit dhe standardeve;
- Rritja e performances se projektit;

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Menjanimi i shpenzimeve lidhur me koston e trajtimit te ndotesve te gjeneruar gjate zbatimit te projektit;
- Ruajtja e biodiversitetit;
- Reduktimi i perdorimit te burimeve;
- Mjedis me i shendetshem per shkak te ruajtjes dhe shtimit te pyjeve, ruajtjes dhe zhvillimit te bujqesise, shtimit te aktiviteteve rekreative dhe vlerave estetike.

Karakteristikat e procesit te hartimit te V.N.M

- *Statusi i projektit, sasia, qellimi dhe grumbullimi i te dhenave:* Kjo faze kerkon identifikimin e statusit te projektit brenda kontekstit te:
 - ✓ Planifikimi dhe legjislacioni mjedisor;
 - ✓ Kriteret dhe politikat lokale, rajonale dhe kombetare mjedisore;
 - ✓ Percaktimi i ndikimeve dhe perfitimeve socio-ekonomike dhe atyre mjedisore, si edhe problemet e mundshme te ligjit, projektit, planit apo programit te propozuar.
- *Dhenia dhe vleresimi i alternativave:* Ketu perfshihet identifikimi i mjeteve dhe qellimeve alternative, permes te cilat mund te realizohet i njejti objektivi, perfshire zonat alternative, madje edhe deri ne alternativen e anulimit te plote te projektit. Ne kete proces behet edhe vleresimi i perfitimeve dhe kufizimeve te politikave, programeve, projekteve permes krahasimit me alternativat e dhena. Eshte e rendesishme qe te identifikohen te gjitha ndikimet e veçuara si edhe ai kumulativ te çdo alternative;
- *Rishikimi i masave zbutese dhe parandaluese te propozuara:* Masat parandaluese dhe zbutese te propozuara per çdo alternative te paraqitur duhet te studiohen me kujdes, me qellim kontrollin e ndotesve, mbrojtjen e natyres dhe menaxhimin e mjedisit;
- *Filtrimi:* Ndikimet e fragmentuara dhe perfitimet, qofshin afatgjata apo afatshkurta te çdo alternative te dhene, krahasohen dhe vleresohen nga grupet e interesit si edhe publiku. Drafti i V. N. M. duhet te perfshije dhe identifikojte edhe alternativat dhe arsytet pse jane dhene. Eshte e domosdoshme te percaktohen, shpjegohen dhe diskutohen ndryshimet dhe risqet mjedisore;
- *Komunikimi:* Gjate procesit te hartimit te draftit, por edhe gjate hartimit te V. N. M. perfundimtare eshte e domosdoshme perfshirja e publik ne debate te zhvilluar per kete qellim. Ky proces realizohet permes takimit me perfaqesues te komunitetit, grupeve te interesit, shoqatave mjedisore apo

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

edhe masmediave. Perfundimet e ketij procesi duhet te perfshihen ne variantin perfundimtar te V. N. M.;

- *Vendimmarrja*: Vendimet e marra duhet te shpallen publikisht, duke nenvizuar gjithë mbeshtetesit e tyre si edhe perfaqesuesit e publikut;
- *Analiza e kostos se projektit*: Monitorimi behet, perpara, gjate dhe ne vazhdim te zbatimit te projektit. Nje prej kushteve per aprovimin e tij, eshte edhe pergatitja e raporteve vjetore, te cilet i vihen ne dispozicion publikut, ku perfshihet i gjithë informacioni i marre mbi gjendjen e mjedisit ne çdo faze te implementimit te projektit. Projekti behet objekt i auditive te vazhdueshme mjedisore. Agjencite mjedisore shteterore kane pergjegjesi per ndjekjen dhe monitorimin e aspekteve mjedisore si edhe plotesimit te standardeve ligjore;
- *Ndikimi ne mjedis*: Ketu behet vleresimi i ndikimit te çdo faktori mbi te tjeret. Ndikimet ne mjedis perfshijne:
 - ✓ Ndotjen dhe efektet ekologjike mbi ajrin, ujin, ndotjen akustike dhe dridhjet, nivelet e rrezatimit, floren dhe faunen, biodiversitetin, shkallet dhe nivelet e komunikimit, shendetin, zonat e mbrojtura, parqet natyrore, trashegimine kulturore dhe historike, erozionin, degradimin e tokes, drenimin dhe rrjetin e kanalizimeve, gjenerimin e ndotesve dhe menaxhimin e tyre si edhe klimen;
 - ✓ Burimet natyrore si tokat bujqesore, pyjet, burimet ujore, burimet minerare, detin, burimet e energjise, inertet, lagunat, koraleve, pyjeve te shiut, jetes se eger dhe shkurreve;
 - ✓ Sociale si punesimi, perdorimi i tokes, strehimi, jeta sociale, mireqenia, aktivitetet shlodhese, sistemet e komunikimit, sherbimet, siguria dhe komoditeti i rezidencave;
 - ✓ Ekonomike si mundesite e punesimit, permiresimi i infrastruktures, sherbimet, zgjedhja dhe mundesia e sigurimit te te mirave dhe sherbimeve.

Sistemet e menaxhimit te mjedisit

Menaxhimi mjedisor eshte nje proces permes te cilit organizatat e ndryshme, percaktojne

metodiken e vleresimit te demeve potenciale te ardhura nga aktiviteti qe ato kryejne dhe mbi kete baze te percaktojne masat qe duhet marre per minimizimin e tyre. Keto sisteme jane pjese e planit teresor te menaxhimit, perfshire strukturen e organizates, planifikimin e aktiviteve, pergjegjesite, praktikat, procedurat, proceset e punes dhe burimet e zhvillimit, implementimin e fazave te ndryshme te

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

projektit, rezultatet, rivleresimet dhe punimet e mirembajtjes si edhe politikat mjedisore. Nje sistem i menaxhimit te mjedisit e lejon organizaten per kontrollin e ndikimeve ne mjedis, te ardhura si pasoje e aktivitetit te tyre. Vete ndermarrjet prodhuese kane standardet e tyre te brendshme lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Keto standarde se bashku me ato nderkombetare kane sherbyer per krijimin e Sistemit te Standardeve te Menaxhimit te Mjedisit, ISO 14001.

1. Konsideratat baze te sistemeve te menaxhimit te mjedisit

Nuk mund te thuhet se ka nje rruge te qarte te implementimit te sistemeve te menaxhimit

mjedisor. Çeshtjet kyçe te aplikueshme ne sistemet e menaxhimit mjedisor jane:

- Marrja e pergjegjesive: eshte hapi me i rendesishem ne zhvillimin e nje sistemi te suksesshem te menaxhimit mjedisor. Mbeshtetja e drejtuesve te kompanise mund te jete e drejtperdrejte ose permes hartimit te politikave te cilat percaktojne qarte pergjegjesite e kompanise lidhur me:
 - ✓ Respektimin e legjislacionit dhe kriterëve ligjore;
 - ✓ Parandalimin e ndotjes;
 - ✓ Permiresimin e vazhdueshem;
 - ✓ Objektivat e kompanise.
- Fusha e perdorimit: Adoptimi i nje plani te menaxhimit mjedisor nuk do te thote qe gjerat (pajisjet teknologjike etj.) duhet te flaken dhe te rinise çdo gje nga e para. Eshte shume e rendesishme te kuptohet dhe te qartesohet se çdo te behet me stokun e krijuar, per shkak te aplikimit te planit te menaxhimit mjedisor, te vihet fokusi ne ri-integrimin e tyre, te permiresohet vazhdimisht teknologjia, te plotesohen boshlleqet mbi standardet dhe teknologjine ne perputhje me prioritetet e kompanise si edhe te shtohet dhe permiresohet baza laboratorike e tyre;
- Iniciativat menaxhuese: Nje plan i menaxhimit mjedisor siguron nje mjet sistematik per integrimin e etikes mjedisore ne çdo aktivitet menaxheria, perfshire edhe permiresimin e vazhdueshem te metodave te mbrojtjes se mjedisit, administrimin e tij si edhe optimizimin e kostos;
- Fokusimi ne programin e punes: Plani mund te jete nje instrument per lehtesimin e menaxhimit te ndryshimeve te pritshme;
- Theksimi i konformiteteve: Plani i menaxhimit mjedisor mundeson vleresimin optimal te çdo lloj burimi dhe programi, permes optimizimit te kostos.

2. Elementet e planit te menaxhimit mjedisor

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Skematikisht elementet perberes te panit te menaxhimit te mjedisit paraqiten ne figuren meposhte.

Nje projekt paraprak i tij perfshin misionin, kushtet, aktivitetet si edhe procedurat qe do te

ndiqen. Nje plan i detajuar menaxhimit te mjedisit permбан:

- Politikat;
- Planifikimin;
- Zbatimi dhe procesi i punes;
- Kontrolli dhe operacionet korrektuese;
- Rivleresimi i planit menaxhues.

3. Auditi i sistemit te menaxhimit mjedisor

Auditi i mjedisit dhe sistemit te menaxhimit te tij eshte nje proces i vazhdueshem, sistematik, i

dokumentuar, periodik dhe objektiv per vleresimin e aktivitetit te ushtruar nga kompania

lidhur me:


- Vleresimin e respektimit te kritereve te brendshme dhe atyre ligjore;
- Menaxhimin e teknologjise dhe kontrollin e praktikave mjedisore;
- Promovimin e praktikave te mira te menaxhimit te mjedisit;
- Ruajtjen e kredibilitetit ne publik;
- Rritjen e kujdesit te stafit me qellim rritjen e pergjegjshmerise se departamentit te mjedisit;
- Zbulimin e mundesive te permiresimit te sistemit;
- Percaktimin e standardeve baze per planin e menaxhimit te mjedisit.

4. Objektivat e auditit mjedisor

Procesi i auditit mjedisor dhe sistemeve te menaxhimit te tij mundeson:

ELEMENTET E PLANIT TE MENAXHIMIT TE MJEDISIT

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”



- Verifikimin e respektimit të standardeve dhe kërkesave ligjore;
- Vlerësimin e politikave dhe procedurave të brendshme të kompanisë;
- Vendosjen e praktikave të mira mjedisore;
- Identifikimin e mundësive për përmirësim të planeve.

5. Vlerësimi i ciklit të jetes

Vlerësimi i ciklit të jetes është një instrument për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin të çdo produkti apo procesi, gjatë gjithë kohës së zbatimit të tij. Ai trajton çdo aspekt duke filluar nga sigurimi i lendeve të para, përpunimi dhe përgatitja e tyre, nxjerrja e produktit përfundimtar nga njesia prodhuese, shfrytëzimi i tij, nxjerrja jashtë përdorimit dhe se fundmi depozitimi (trajtimi) përfundimtar i tij. Ky cikël mundëson po ashtu llogaritjen e energjisë dhe materialit të nevojshëm për prodhimin e produktit si edhe sasisë së përgjithshme të mbetjeve që do të leshohen mbi mjedisin. Përmes këtij procesi synohet të llogariten ndikimet si edhe të vlerësohen mundësitë e përmirësimit të procesit. Vlerësimi i ciklit të jetes është pjesë e standardeve ISO 14 000 dhe përbëhet nga komponentet e mëposhtme:

- ISO 14040 i cili trajton Menaxhimin e Mjedisit-Vlerësimin e Ciklit të Jetes-Parimet dhe Programin e Punës;
- ISO 14041 i cili trajton Menaxhimin e Mjedisit-Vlerësimin e Ciklit të Jetes-Analizen e Inventarit;

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- ISO 14042 i cili trajton Menaxhimin e Mjedisit-Vleresimin e Ciklit te Jetes-Vleresimin e Ndikimeve;
- ISO 14043 i cili trajton Menaxhimin e Mjedisit-Vleresimin e Ciklit te Jetes-Interpretimin.

6. Procedura e vleresimit te ciklit te jetes

Procedura e vleresimit te ciklit te jetes ka kater etapa, te cilat jane:


- Percaktimin e qellimit, synimeve, objektivave dhe kufijve te ciklit te jetes. Ky proces

bazohet ne:

- ✓ Qellimet e studimit;
 - ✓ Produkti i prodhuar dhe alternativat;
 - ✓ Cili eshte cikli i jetes se produktit;
 - ✓ Çfare eshte lene jashte dhe pse?
- Pergatitjen e inventarit. Pasi sistemi konturohet qarte dhe me sakte, duhet te behet vleresimi i efekteve te pritshme. Ketu perfshihen ndikimet mbi mjedis, konsumin e burimeve primare, kushtet e punes etj. Cilesia e informacionit te marre ka rendesi shume te madhe per analizen dhe perllogaritjen e sakte te ciklit te jetes. Nuk duhet te lihen pas dore edhe informacionet e konsideruara si dytesore, te cilat mund te dalin te domosdoshme ne mungese te te dhenave te rendesishme;
 - Vleresimin e ndikimit ne mjedis bazuar ne ngarkesen faktike. Duhet te behet klasifikimi i inputeve dhe outputeve, konsumit te burimeve, kontributin e tyre ne problemet mjedisore dhe mjedisin e punes. Ndikimi potencial bazohet ne:
 - ✓ Ndikimi mbi mjedis;
 - ✓ Konsumi i burimeve;
 - ✓ Kushtet e punes.
 - Vleresimin e ndikimit ne mjedis bazuar ne objektivat e paravendosur te kompanise. Konsiston ne krahasimin e alternativave te dhena per produktin, profilin mjedisor, profilin e burimeve dhe kushteve te punes. Procesi i vleresimit mundeson perzgjedhjen e projektit me ndikimin minimal mbi mjedis.

7. Cikli i jetes se nje produkti

Çdo faze e ciklit te jetes se nje produkti perfshin inputet e materialeve dhe energjise si dhe outputin e produktit vete, perfshire edhe emisionet e çliruara ne mjedis gjate ketij procesi. Skematikisht cikli i jetes si nje produkti paraqitet ne figuren meposhte.



Minimizimi i ndotjes

Minimizimi i ndotjeve duket se është alternativa më e mirë për zgjidhjen e problemeve mjedisore të shkaktuara nga zhvillimi i shpejtë i sektorit industrial. Përveç reduktimit të ndotesve, përmes këtij procesi rritet rendimenti dhe ulët kostoja e produkteve.

Vlerësimi i riskut mjedisor

Vlerësimi i riskut po aplikohet përherë e më shumë në shqyrtimin e problemeve mjedisore të çfaredo natyre qofshin ato. Rreziku perkufizohet si "Një veti, gjendje apo situatë e cila në rrethana të percaktuara shkakton dëm". Risku është më i vështirë për tu perkufizuar. Termi risk në jetën e përditshme nënkupton "Probabilitetin që të ndodhin katastrofa, dëm,

shkatërrime etj". Gradualisht në politikën mjedisore është kaluar nga ato të bazuar mbi rrezikun në ato të bazuar mbi analizën e riskut. Kjo ka ndodhur edhe për shkak të faktit se

pergjithësisht pranohet që çdo projekt të ketë një nivel, qoftë edhe fare të vogël, por brenda limiteve të pranueshme, skenarë risku. Vlerësimi i riskut është një procedurë përmes të cilit bëhet vlerësimi sasior dhe cilësor i çdo rreziku potencial të procesit të punës. Nëse shihet cikli i jetës së një kimikati, risku shfaqet që në procesin e prodhimit, të shpërndarjes, përdorimit dhe depozitimit përfundimtar të tij. Risku vlerësohet duke percaktuar një njësi matëse të dëmit dhe shkallës së tij, pra ky si efekt mbi popullatën dhe mjedisin. Pra, në terma më të gjera duket se vlerësimi i riskut bëhet më qellim që të shqyrtohen dhe identifikohen ndikimet e çdo lloji produkti mbi shëndetin njerëzor (Vlerësimi i Riskut Shëndetësor-Health Risk Assessment) dhe mbi ekosistemet (Vlerësimi i Riskut Ekologjik-Ecological Risk Assessment). Vlerësimi i Riskut Mjedisor (Environmental Risk Assessment) përfshin studimin e detajuar të riskut të çdo lloji teknologjie mbi ekosistemet, kafshët dhe njerëzit. Ky proces përfshin vlerësimin e riskut mbi shëndetin e

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

njerezve, vleresimin e riskut ekologjik apo ekotoksik si edhe disa vleresime shume specifike te riskut industrial mbi popullaten, biotat dhe ekosistemet.

Vleresimi i riskut behet me qellim qe te mundesohet vendimmarrja me e mire. Fillimisht insistohej qe vleresimi shkencor i riskut duhej te shihej i ndare nga procesi i vleresimit te

riskut te politikave menaxheriale, por tashme eshte pranuar prej kujtudo qe keto vleresime jane te pandashme. Menaxhimi i riskut perfshin procesin e vendimmarrjes, per perzgjedhjen e zgjidhjes optimale me qellim qe te merren rezultatet e kerkuara. Me rezultate te kerkuara kuptohen standardet ligjore, rezultatet e perftuara nga procesi i analizes Kosto-Fitim-Risk apo edhe procese te tjere si “Normativat Industriale” apo “Praktikat e Mira”. Risku mund te menaxhohet ne shume menyra. Risku mund te eliminohet, transferohet, frenohet apo edhe minimizohet. Minimizimi i riskut realizon reduktimin e tij deri sa te arrije nivele te pranueshme, te percaktuar mbi bazen e normativave ligjore, standardeve qeveritare, normativave industriale si edhe faktoreve ekonomik, sociale dhe kulturore. Vleresimi i riskut perfshin dy analiza:

- Sasiore;
- Cilesore.

Vleresimi i riskut dhe teknikat e menaxhimit te tij aplikohen ne gjithe nivelet e politikave dhe te standardeve, disa prej te cilave jane:

- Hartimi i rregulloreve per percaktimin e nivelit te lejuar si nivel baze per percaktimin e standardeve mjedisore;
- Sigurimin e informacionit te nevojshem per realizimin e vendimmarrjes;
- Prioritizimin e riskut mjedisor;
- Krahasimin e riskut.

Vleresimi i riskut mjedisor ne sektorin industrial mundeson:

- Respektimin e legjislacionit;
- Sigurine e produkteve;
- Planifikimin;
- Vendimmarrjet specifike;
- Prioritizimin dhe vleresimin e masave per minimizimin e riskut.

Procesi i vleresimit te riskut mjedisor kalon neper etapat e meposhtme:

- Formulimin e problemit;

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Identifikimin e riskut;
- Vleresimin e emisioneve;
- Vleresimin e ekspozimit;
- Vleresimin e pasojave;
- Llogaritjen e riskut.

Parimi: Ndotsi paguan

Sipas ketij parimi saktësohet se kushdo qe demton mjedisin duhet te paguaje per te. Ne 1972, keshilli i OECD (Organisation for Economic Cooperation and Development-Organizata per Bashkepunimin dhe Zhvillimin Ekonomik) aprovoi Rekomandimet per Kornizen Drejtuese mbi Elementet Ekonomike Nderkombetare te Politikave Mjedisore te cilat nderthurnin dhe perbenin formulimin e pare te pranuar nderkombetarisht, te parimit: Ndotsi paguan. Ne nenin 16 te marreveshjes se Rios specifikohet se ndotesi duhet te paguaje per pastrimin e ndotesve, rehabilitimin e mjedisit si edhe kompensimin e plote te demeve te shkaktuara.

Elementet perberes te parimit: Ndotsi paguan

Elementet perberes te ketij parimi jane:

- Ndotja;
- Ndotsi;
- Detyrimet e ndotesit;
- Kostoja e ndotjes.

IV. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHEM TE ZBATOHEM PROJEKTI

Flora

Flora eshte relativisht e pasur. Ne kete zone rritet kryesisht dushku, icili perben kryesisht pyll te ri, pra me i perhapur eshte dushku, dellinja, te gjitha te familjes se shkurreve si dhe ne lartesite mete medha edhe pisha e ahu. Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj specie flore apo faune qe mbrohet me status te vecante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, mbasi siperfaqja e objektit eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia dhe nuk ka asnje lloj bime uji. Ne pergjithesi

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

zona ku ndodhet vendburimi i kromi eshte e zhveshur nga bimesia. Ajo perfaqesohet nga nje bimesi e ulet si bush, dushk, dellinje e me rralle frasher.

Ne kete zone rriten vetem shkurre te llojeve te ndryshme, qe nga bushi, dushku i rralle, ferra etj., por kemi edhe ah me me pakice.



Pamje e siperfaqes se objektit

Fauna

Ne kete zone do te dallonim boten shtazore te shkurreve, te pyjeve te ahut dhe te dushkut ne

lartesine interesante te kullotave alpine dhe te pak habitateve ujore.

Nga analiza e botes se gjalle mund te dalim ne keto konkluzione: zona ka bimesi te paket, por shume te larmishme, ku midis tyre dallohen ekosistemet pyjore te shkurreve, te dushqeve, te kullotave alpine, si edhe ajo e siperfaqeve te degraduara te gjitha keto ekosisteme kane vlera te vecanta sidomos ne sektore te caktuar me vlera shkencore dhe turistike. Shumellojshmeria e flores duke filluar nga shkurret mesdhetare e deri tek kullotat alpine ben te mundur nje pasuri per shfrytezim per qellime te ndryshme si ajo blektorale, industria e perpunimit te drurit, turizmi etj. Pasuri te madhe perbejne edhe llojet e shumta te bimeve mjekesore si kamomili, dellinja, salepi, mellenja, sherebeli qe perdoren per shitje nga popullsia e zones duke marre perfitime jo te vogla ekonomike. Kjo lloj bimesie ka ndikuar ne zhvillimin e zones pasi ne Diber ka shume lloje bimesh qe gjejne kushte te pershtatshme. Ne kete zone eshte e zhvilluar pemetaria, vreshtaria si edhe shume lloje bimesh.

Karakteristikat klimatike

Zona ne studim karakterizohet nga nje klime tipike kontinentale, me vere te shkurter, te fresket e rreshje te shumta dhe dimer te gjate, te ftohte dhe me

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

rreshje te shumta, kryesisht ne trajte debore. Rreshjet ne vere jane ne trajte shiu, shpesh me stuhi, tipike per kete lloj zone, mbi 700 m mbi nivelin e detit, ndersa ne dimer ne trajten e shiut dhe te debore, trashesia e se ciles shkon nga 0.5 m deri ne 1,5- 2m.

Temperaturat ne vere arrijne deri + 25 °c, ndersa ne dimer shkojne deri- 20 °c. Ne pergjithesi kjo zone rrihet nga ererat e ftohta, kryesisht nga Veri-Lindja dhe rralle nga jugu.

Ne kete rajon debora fillon nga muaji Nentor dhe mbaron ne muajin Mars, e ndonjehere deri ne Maj. Klima e ftohte dhe rreshjet e shumta te debores bejne qe gjate kesaj periudhe te kemi nderprerje te punes, e cila duhet te merret ne konsiderate.

Mjedisi fizik

Rrethi ben pjese ne Qarkun te Dibres. Rrethi i Dibres ka 86.000 banore (sipas 2004), me nje siperfaqe prej 761 km² dhe kryeqender Peshkopine. Rrethi i Dibres ben pjese ne rajonin verioro-lindor me nje relief pergjthesisht maloro-kodrinor. Pra shtrihet ne veri-lindje te Shqiperise ne dy anet e lugines se Drinit te Zi duke u kufizuar ne lindje nga vargmali i Korabit dhe ne perendim nga vargmalet e Lures.

Qendra e rrethit (Peshkopia) qe shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largesi nga pika e doganes se Bllates ne Maqellare. Kufizohet nga kufij konvecionale ne lindje me Republikën e Kosoves dhe te Maqedonise me nje gjatesi kufitare 90 km, nga te cilat 19 km jane lumore. Ne veri kufizohet me rrethin e Kukesit me 75 km vije kufitare. Ne perendim me Mirditen 13 km vije kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vije kufitare. Ne jug me Bulqizen 7,8 km vije kufitare. Ky rreth ka nje ndertim te komplikuar gjeologjik qe eshte kapur here pas here nga levizjet neotektonike ngritese qe ka luajtur nje rol te rendesishem ne formimin e relievit. Rrethi i Dibres ka nje relief kodrinor- malor qe varion nga 350m (lugina e Drinit te Zi) deri ne 2751 m ne majen e Korabit. Ben pjese ne zonen klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore meqenese eshte pjese perberese e pellgut te Drinit te Zi. Ka nje hidrograf i te pasur me burime mbitokesore dhe nentokesore ku dega kryesore eshte Drini i Zi. Dibra dallohet per shumellojshmerine e tokave, te cilat per shkak te relievit malor shprehen qarte. Gjejme brezin e tokave aluvionale rreth lumit te Drinit te Zi, te kafejta, te murrme pyjore dhe ate livadhore malore. Ne kete takojme breza bimore si: brezi i d ushqeve, ahishteve dhe kullotave alpine. Ky rreth ka nje popullsi prej 75,000 banoresh te vendosur ne 1088 km² kryesisht ne vendbanime te rralla e rurale. Objekti lidhet me rruge automobilistike nacionale

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit "Fushe Lope"

Bulqize- Kraste nepermjet degezimit djathtas me rrugen per tek objekti "Fushe Lope", Letaj, Kraste, Martanesh, Rrethi Bulqize, qarku Diber, si dhe nepermjet rruges qe lidh kete objekt me minieren e Theknes. Objekti i kerkuar per VNM ndodhet ne ndarjen administrative te Rrethit te Bulqizes, Qarku Diber.

Objekti i kromit "Fushe Lope", Letaj ndodhet ne afersi te fshatit Kraste, Martanesh ne Jug- Perendim te tij, eshte pjeserisht i studiuar nga sherbimi gjeologjik, por per natyren e trupave, zbulimi me efikas, do te ishte zbulim dhe shfrytezim i tij. Ne afersi te objektit jane shfrytezuar pjeserisht vend burimet e kromit Kraste, Martanesh. Objekti i kromit "Fushe Lope", Letaj ben pjese ne zonen Lindore malore, ne lartesine mesatare + 900 m deri ne +1100 m mbi nivelin e detit. Qendra me e banuar me e afert eshte fshati Kraste, Martanesh, me rreth 1000-1500 banore, i cili ndodhet ne vije ajrore 2.5 km me ne Veri-Lindje te objektit. Ai ndodhet ne rrethin e Bulqizes, rreth 160 km nga Tirana, 30 km nga qyteti i Bulqizes .

Gjeologjia

Ndertimin gjeologjik te zones Kraste, Martanesh duhet ta shohim te lidhur me ate te rajonit Bulqize. Referuar harte Gjeologjike 1- 2 000 kemi nje ndertim te larmishem si nga ana formacionale ashtu dhe te ndertimit gjeologo-tektonik.

Shkembijnjte ultrabazike kane nje perhapje te konsiderueshme ne pothuaj te gjithe rajonin. Ata perfaqesohen nga shkembinj harcburgitik, harcburgit-dunite, dunite harcburgite te zones se tranzicionit, harcburgite, verlite, verlit e plagioklazike, piroksenite e ne vazhdimesi kompleksi

gabro-norit. Shkembijnjte kane renie Perendimore, por nuk mungojne dhe ato Lindore e Jug-

Lindore. Dunitet jane me orientim Veriperendim-Juglindje, duke qene konkordante me mineralizimin e kromit, ne trajte linzash brenda harcburgiteve.

Rajoni ku ben pjese objekti i kromit "Fushe Lope", Letaj eshte pjese e masivit ultrabazik te

Bulqizes. Ai ndodhet ne pjesen lindore te ketij masivi dhe iperket brezit lindor te ofioliteve te Shqiperise. Nga ana strukturore ben pjese ne zonen "Mirdita". Ne pjesen Veri-Lindore kontakton me depozitimet karbonatike te triasik. i sipe-jurasik i poshtem T3 -J1 te Zerqanit dhe Ures se Qytetit dhe me pas me zonen tektonike "Korabi". Ne rajonin tone bejne pjese shk.embijnjte ultrabazike, bazik.e, depozitirnet efuzivo-sedirnentare, depozitimet karbonatike triasike, depozitimet karbonatike kretake, depozitimet neogjenike e ato te plio-kuatemarit.

Gjeologjia e rajonit

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

a) Shkembijnjte ultrabazike. Ato perfaqesohen nga shkembijnjte ultrabazike si peridotite, dunite e seria damarore. Shkembijnjte ultrabazike ndahen ne keto zona litologjik.o-faciale:

1) Zona e harcburgit-duniteve mantelore nderton pjese me te thella te masivit me nje trashesi 2,5- 7 km. Ajo perfaqesohet nga harcburgite te serpentizuara, harcburgite te freske si dhe dunite ne trajte linzash apo brezash me trashe te vogel.

2) Zona e tranzicionit, perbehet nga linza e shtratime dunitesh te ndrthurura me dunite ortopiroksenore shume te konsumuara. Kjo sekuenca vendoset ne pjese me te sipërme te harcburgit-duniteve ne pjesen kalimtare per ne kumulatet ultrabazike.

3) Dunitet masive kumulate perbehen nga dunite te vendosura ne trajte shtratimesh.

b) Shkembijnjte bazike. Kane perhapje te vogel dhe takohen ne pjesen jugore e verilindore.

Perfaqesohen kryesisht nga gabro e gabro-norite masive.

c) Depozitimet efuzivo-sedimentare. Kane dalje shume te kufizuara dhe nuk jane determinuese ne ndertimin gjeologjik te rajonit. Depozitimet karbonatike triasike. Takohen ne Veri te rajonit ne studim. Eshte pjese perberese e komizes per kalimin ne zonen Korabi. Perbehen nga gelqerore shtresore e shtrese trashe me ngjyre gri. Jane datuar ai gelqerore te triasikut te siperm shkojne deri ne jurasikun e poshtem.

e) Depozitime karbonatike kretake. Keto depozitime vendosen transgresivisht rmbi shkembijnjte ofiolitike nepermjet kores se prishjes. Nodohen ne pjesen veriore te rajonit e konkretisht te Ura e Qytetit, 1500 m rmbi nivelin e detit. Perfaqesohen nga gelqerore shtrese-trashe e masive me ngjyre gri te erret.

Depozitime neogjenike dhe plio-kuaternarit. Kane perhapje te vogel ne zone. Takohen ne zone perendimore. Perbehen nga depozitime copezore si konglomerate, ranore, argjila e deluvione.

Gjeologjia e objektit

Objekti ben pjese ne masivin ultrabazik te Bulqizes. Ai ndodhet ne pjesen lindore te tij. Nga pikepamja litologjiko-faciale ky vendburim ben pjese ne zonen harcburgit-dunite mantelore nderton pjeset mete thella te masivit. Ne ndertimin gjeologjik te objektit marrin pjese kryesisht shkembijnjte ultrabazik mbulohen transgresivisht ne lindje dhe ne veri nga gelqeroret e kretakut te siperm, ne pjesen perendimore dhe veriperendimore kontaktojne tektonikisht me shkembijnjte gabrore. Shkembijnjte ultrabazike perfaqesohen nga dunitet intensivisht te serpentizuara, peridotitet intensivisht te serpentizuara, serpentinitet

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

dhe shkembinjte damarore.

Ndertimi gjeologjik i vendburimit

Formacionet shkembore qe marrin pjese ne ndertimin gjeologjik te zones jane kryesisht perdotitet (harcburgitet) me nderthurje masivesh te vegjel dhe linzash dunitike. Marrin pjese dhe lloje te tjera shkembore si: serpentinitet, seria damarore e perbere kryesisht nga facia ultrabazike (piroksenitet dunitet, plagjioklazi, etj) si dhe depozitimet karbonatike etj. Me poshte, po pershkruajme ne menyre pak me te detajuar, te gjitha llojet shkembore, qe marrin pjese ne ndertimin gjeologjik te kesaj zone.

Llojet shkembore

Peridotitet (harcburgitet)

Ky tip shkembor, ashtu si ne te gjitha masivin ultrabazik te Bulqizes, jane llojet shkembore me te perhapur dhe ne kete zone. Kjo dhe per faktin se, sic e kemi thene dhe me lart, zona ne fjale, ben pjese ne shtratimin magmatik te kumulateve. Zene rreth 55-60 % te mases shkembore ne teresi. Kane ngjyre jeshile te erret deri ne te mbyllur dhe ndertim kristalin mezo deri makrokorrizor. Perbehen nga olivina, pirokseni rombik, shume rralle pirokseni monoklin dhe kromshpinelidi aksesor. Nga mineralet dytesor takohen serpentina, me rralle talku, amfiboli dhe kloriti. Kristalet e piroksenit jane te zhvilluara mire. Kane madhesi deri 0.2-6 mm dhe dallohen qarte ne masen shkembore per faktin se kane shkelqim metalik.



Pamje e shkembinjoe qe marrin pjese ne ndertimin e objektit minerar dhe te zones

Ne siperfaqe, meqenese i jane nenshtruar proceseve te alterimit, ne dallim nga dunitet, krijohet nje reliev i ashper, lehtesisht i dallueshem qe nga larg, qe tregon se kemi te bejme me formacione shkembore peridotitike. Ne pergjithesi peridotitet i jane nenshtruar proceseve dytesore, nen veprimin e hidrotermave te ftohta (ujrave) dhe per pasoje, format e fresketa takohen pak. Format pak deri mesatarisht te serpentinizuara takohen me shpesh. Ato kane ngjyre me te mbyllur se format e fresketa. Ne masen shkembore te peridotiteve dallohen mire kokrriza te kromshpinelidit, te shperndara uniformisht dhe qe perbejne 2-3 % te mases shkembore ne teresi. Peridotitet pershkohen nga seria damarore, e cila i nderpret ato me kontakte te qarta dhe te prera. Keto lloje shkembore kane fortesi te madhe e qendrueshmeri te larte dhe per pasoje nuk paraqesin probleme gjate avancimit te punimeve minerare, madje, ato konsiderohen te favorshem.

Dunitet

Keta lloje shkembinjsh jane te dytet persa i takon perhapjes ne masivin shkembordhe kryesisht i perkasin nivelit te breznimeve harcburgit-dunit. Pra ata i perkasin nivelit te thelle ne prerjen magmatike. Zene rreth 20-25 % te mases

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

shkembore ne teresi. Vendosen ne ambjentin e peridotiteve (harcburgitik), ne forme masivesh te vegjel dhe thjerrzash dhe zgjaten ne perputhje me shtrirjen e struktures se masivit ne teresi, VP-JL, me azimut shtrirje 310-340o. Kane ngjyre jeshile te eret, pak me te hapur se peridotitet dhe ndertim kristalin mezo deri makrokorrizor. Perbehen kryesisht nga olivina, me pak permbajtje te piroksenit rombik, i cili ze rreth 10-12 % te mases se tyre shkembore. Kristalet e piroksenit jane me pak te zhvilluar se tek peridotitet. Kane permasa deri 1-2 mm dhe dallohen mire ne masen shkembore per shkak te shkelqimit metalik te tyre. Ne siperfaqe, ne ndryshim nga peridotitet, proceset e alterimit, krijojne nje relief disi te rrumbullakosur, mjaft te copezuar e te thermuar, qe gjithashtu dallohet qarte qe nga larg, si vecori e fomacioneve dunitike Ashtu si dhe peridotitet, i jane nenshtruar proceseve dytesore te veprimit te hidrotermave te ftohta (ujrave), duke shkaktuar ne kete lloj menyre, serpentinizimin ne shkalle te ndryshme te tyre. Format e fresketa takohen rralle. Me shpesh takohen format pak deri mesatarisht te serpentinizuara, te cilat kane ngjyre me te erret se format e fresketa. Ne masen shkembore te tyre dallohen kokrriza kromshpinelidi, te shperndara pak a shume ne menyre te njetrajtshme dhe qe perbejne gati 3-4 % te mases shkembore ne teresi. Vende-vende takohen dhe formime kromifere zinxhirore, shliresh, xhepush, folesh apo formash te tjera. Takohen ne forme masivesh te vegjel, linzash etj, Me peridotitet kane kontakte normale, me kalime te dora-dorshme. Pershkohen teresisht nga seria damarore. Jane formacione shkembore me qendrueshmeri te mire dhe nuk paraqesin probleme gjate avancimit te punimeve minerare neper to. Me to lidhet egzistenca e mundeshme, e mineralizimeve kromifere

Serpentinitet

Keta shkembinj jane lloje shkembore, te formuar si rezultat i ndryshimit te formacioneve shkembore paresore, sic jane peridotitet dhe dunitet, prej proceseve dytesore, si rezultat i veprimit te hidrotermave te ftohta (ujrave). Kane ngjyre jeshile te erret deri te zeze, gri te mbyllur, etj. Pergjithesisht paraqiten me forma te lemuara dhe qe kane nje lloj shkelqimi karakteristik per to. Ashtu si ne shkembinjte meme te tyre, verehen neper to, pikezime te kromshpinelidit, te shperndara ne menyre pak a shume uniforme dhe qe perbejne deri 4 % te mases shkembore. Per shkak te ngjyres dhe formes se tyre, dallohen shume qarte nga formacionet e tjera shkembore (shkembinjte meme te tyre). Takohen gjithandej ne masiv, por shume shpesh gjenden ne dhe prane zonave te fuqishme tektonike. Zene rreth 10-12 % te mases shkembore gjithsej. Pershkak te ndryshimeve rrenjesore qe kane pesuar, kane fortesi te vogel dhe qendrueshmeri te ulet, shpesh here shume te ulet, gje qe ne mjaft raste krijon avari te renda na avancimin e punimeve minerare.

Seria damarore

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Keta shkembinj perfaqesohen nga formimet paresore magmatike dhe formimet dytesore.

- **Formimet paresore magmatike**

Keto formime perfaqesohen kryesisht nga damare te pirokseniteve dhe me rralle te duniteve. Duke qenese vendosen ne sistemin paresor te carjeve, nderpresin te gjithë llojet shkembore dhe formojne nje rrjet te dendur, me pamje paralelogramesh, me dendesi mesatarisht 2-3 ml. Shpesh here kjo seri nderpret edhe trupat kromifere, ne ato zona ku ato takohen. Trashesia e tyre eshte nga disa cm deri ne disa dhjetra cm dhe rralle mund te arrije deri ne nje meter. Me shkembinjte rrethues kane kontakte te qarta e te prera dhe duke qenese keto kontakte jane te nxehta, kane lidhje te mira me to. Perbehen kryesisht nga pirokseni rombik, kristalet e te cilit jane te formuara mire dhe kane madhesi nga disa mm deri ne nje centimeter. Damaret e pirokseniteve perfaqesohen nga ortopiroksenite te tipit enstatit-bronzit, vebsterite dhe dhe te diopsidit. Zene rreth 5-7 % te mases shkembore ne teresi. Kane fortesi mjaft te madhe dhe qendrueshmeri shume te larte.

- **Formimet dytesore**

Keto formime perfaqesohen nga formime damarore karbonatike te aragonitit, kalcitit dhe me rralle te magnezitit. Jane produkt i proceseve hidrotermale te ftohta (ujrave). Vendosen ne sistemin e carjeve paresore, linjave apo zonave te fuqishme tektonike, si material mbushes i tyre. Kane ngjyre hiri, te bardhe ne te qumesht, deri ne krem, ndertim kristalin, ne rastin e kalcitit me kristale te formuara shume mire, thyerje guackore. Zene rreth 3-5 % te mases shkembore ne teresi.

Popullsia

Zona eshte e banuar nga banore te fshatit te Krastes, Martanesh, qe ruajne traditat mete mira prej shekujsh si mikepritje, burreria, besa etj. Ata e kane ndertuar ekonomine e tyre nepermjet bujqesise dhe blegtorise, si dhe pjesa qe mundet te punesohet edhe me minierat. Me te perhapura jane dhite dhe lopet, kurse misri, fasulja e pak perime, kurse nga druret frutore jane te perhapura kumbullat, mollet arra etj. Me shtimin e emigracionit zona ka marre nje zhvillim me te madh ekonomik dhe sidornos sfera e ndertimeve.

Objekti i kromit ndodhet rreth 20 km ne Jug-Lindje te fshatit Zerqan dhe 2.5 km ne Perendim te fshatit Kraste, Martanesh dhe rreth 30 km nga qyteti i Bulqizes. Zona ku do te zhvillohet aktiviteti minerar ka infrastrukture te zhvilluar ne drejtim te rrugeve nacionale, por me nevoja per perniresim persa i perket atyre qe te cojne ne sektoret e punes. Ajo eshte e lidhur me rrugen nacionale Burrel -

Peshkopi.

Persa i perket infrastruktures ekzistuese, zona ka nje infrastrukture relativisht te dobet. Fshatrat pershkohen nga rruga automobilistike Fushe Bulqize - Kraste, Martanesh. Ne fshatin Kraste, Martanesh eshte ndertuar shkolla e 9-vjecare ku marrin mesimet e para femijet e kesaj zone. Prane objektit nuk ka objekte te nevojshme siperfaqesore, te cilat mund t'i sherbejne subjektit per zbulimin dhe shfrytezimin e rezervave te mineralit te kromit.

Trashgimia arkitektonike dhe historike

Ne kuadrin e pergjithshem te vleresimit dhe menaxhimit te burimeve natyrore, si dhe mbrojtja e mjedisit, nje vend te rendesishern ze edhe perfshirja e siperfaqeve te caktuara ne rrejetin e zonave te mbrojtura. Edhe ne vendin ku do te zbatohet projekti nuk ka zona te mbrojtura.

Zhvillimi ekonomik i rajonit

Zona ku ben pjese objekti, eshte zone rurale dhe popullsia kryesisht eshte marre dbe merret me pune bujqesore dhe blegtorale. Nje numer i konsiderueshem banoresh punojne ne emigracion dhe ne objektet e tjera te karakterit minerar dhe te ndertimit. Bujqesia ze vend shume te ulet per mungese se tokes se bukes, si dhe relievi teper malor qe nuk e favorizon. Fillimi i aktiviteti minerar, do te bente te mundur hapjen e vendeve te reja pune dhe do te zbus sado pak largimin e popullsisë. Popullsia, relativisht eshte ne gjendje ekonomike nen mesatare.

V. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE

Hidrografia dhe hidrogeologjia

A. Hidrografia

Ne kete teritor, ne pjesen veri lindore te tij kalon perroi Zybertes i cili e ka burimin disa kilometra ne lindje te objektit dhe bashkohet me perrenjte e tjere si Perroi Thekres qe shtrihete ne juge te objektit dhe perroi i Thelle .

Zona pershkohet edhe nga disa proska te vogla te cilat nuk kane uje gjate gjithe vitit Ne kohen e vjeshtes dhe pranveres, kur bien rreshje dhe shkrin debora prurjet ne perrenjet e zones jane te konsiderueshme.

Ne brendesi te zones ku do te kryen punimet e shfrytezmit kalojnvetem Perroi i Zybertes dhe ai i Thelle te cilet ne dimer dhe pranvere ka prurje te relativisht te konsiderueshme (kryesisht ne dimmer) por qe nuk e ndikojne shfrytezimin e

kesaj zone mbasi rezervat ndodhen ne kuota te larat mbi 900m

B. Hidrogjeologjia

Gjatë avacimit të punimeve minerare te kerkim zbulimit ne afersi te objektit tone si dhe brenda tij , janë takuar rrjedhje të ujrave n/tokesore. Ato burojnë nëpër çarjet dhe zonat tektonike. Prurjet e tyre ndryshojnë në varësi të stinëve dhe reshjeve atmosferike, gjë që tregon se ato ushqehen nga reshjet atmosferike. Zonë ushqimi, për objektin e kromit “Fushe Lope” Letaj janë reshjet e shiut dhe pllajat ne veri dhe perendim te objektit, te cila në dimër mbulohen nga reshje të shumta dëbore, që shkrin në muajt prill-maj. Ndryshimi i shpejtë i prurjeve të ujrave n/tokësore, në varësi të reshjeve, tregon për komunikimin hidraulik të sistemit të çarjeve dhe linjave tektonike. Në përgjithësi, me gjithë rrjedhjet e ujrave n/tokësore që ka, ato nuk kanë sjellë probleme serioze në aktivitetin minerar te minierave te njohura ne rajon. Për përbërjen kimike të ujrave n/tokësore janë bërë analiza kimike e bakterologjike nga rezulton se ujrat e shkëmbinjve ultrabazikë i përkasin tipit karbonatik-magnezial, janë kimikisht dhe bakterologjikisht të pastër, nuk janë agresivë dhe janë shumë të përshtatshëm si ujra të pijshëm.

VI.

I

INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis

Veprimtaria minerare qe do te zhvillohet ne mjedis do te shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne te. E rendesishme eshte qe te analizohen keto procese, forma e shfaqjes se tyre dhe ajo qe eshte me e rendesishme dhe kryesore, te analizohen ndikimet e cdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te rinovueshme dhe te parinovueshme, per te parashikuar ndotjen dhe ndikimin ne mjedis. Burimet minerare jane burim natyror shume i rendesishem per vendin tone. Ne kete kuader industria nxjerrse e mineraleve ka nje rendesi te vecante per ekonomine e vendit.

Vec kesaj, nxjerrja e mineraleve nga nentoka dhe siperfaqja shoqerohet me ndikime ne mjedis dhe elemente te tij, ndikime, te cilat ne rast se nuk kontrollohen dhe nuk merren masa per rehabilitim behen negative dhe behen te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative negative mjedisore mund te minimizohen deri ne eliminim permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit "Fushe Lope"

aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise, behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjeneruara, te gjitha keto ne kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Shfrytezirni i resurseve minerare, per vete faktin se ato jane nentoke apo ne siperfaqen e tokes, kerkon perdorimin e makinerive te renda, pajisjeve dhe ne rastin e studimit tone edhe perdorimin e lendeve plasese. Ne shfrytezimin me miniere nentokesore te mineralit te kromit ne objektin "Fushe Lope", Letaj, Kraste, ndikimet me thelbesore mund dhe duhet te analizohen sipas fazave te veprimtarise dhe konkretisht:

- Faza pergatitore, e cila lidhet me hapjen e galerise
- Faza e shfrytezimit, e cila lidhet me punimet nxjerrese te mineralit te kromit dhe te gjitha operacionet ndihmese.
- Faza perfundimtare, e cila lidhet me mbylljen dhe rehabilitimin e objekteve minerare, simbylljen e galerise, shesheve te depozitimit te sterilite dhe te mineralit, si dhe riaftesimit te proceseve natyrore.

E rendesishme eshte te kuptohet dhe te qartesohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, ne menyre qe te percaktohet qartelloji indikimeve:

- Te kthyeshme ne mjedis
- Te pakthyeshme ne mjedis

Gjithashtu verejme se te dyja llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative, ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizimin e proceseve te natyres dhe rigjenerimit te ekosistemit.

Metoda e identifikimit te ndikimeve negative

Per vleresimin e ndikirneve ne mjedis nga projekti u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij, menyra e propozuar per shfrytezim, sasite nxjenese, makinerite, etj.
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese te trasheguar te objektit (galeri, shpimi, kanale, etj.) dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe te siperfaqes.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis (germime,

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

stokime te mineralit te kromit e sterilit, ndertime, etj.)

- Konsultimi me shume dokumenta e raporte te VNM-ve, per veprimtari te njejta.

Identifikimi i ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së shfrytëzimit

Mënyra e propozuar e shfrytëzimit sipërfaqësor dhe nëntokësor parashikohet të shkaktojë ndikime negative mjedisore vetëm në receptorë të veçantë të mjedisit. Më konkretisht këto ndikime do të kategorizoheshin në,

1. Ndikime në nëntokë dhe proceset sipërfaqësore të tokës
2. Ndikimet negative në ajër
3. Ndikimet negative mjedisore në biodiversitet (faunë)

Ndikimet e mundshme mjedisore në nëntokë dhe proceset sipërfaqësore të tokës

Gjatë fazës së shfrytëzimit me galeri shkëmbi tokëformues me interes minerar do të nxirret nga nëntoka në sipërfaqe. Ndikimet e mundshme negative lidhen me ndryshimet në strukturën e nëntokës dhe dëmtimin e saj për llogari të nxjerrjes së mineralit. Si pasojë e plasjeve dhe gërmimeve struktura e nëntokës mund të pësojë çarje ose shëmbje. Por sipas raportit teknik të paraqitur nga kompania, paneli i kërkuar për shfrytëzim nuk formon hinka në sipërfaqe dhe nuk krijon zona rreziku në asnjë pikë të fushës minerare. Po kështu nuk parashikohet të ketë zhvendosje të shkëmbinjve si pasojë e shfrytëzimit nëntokësor, pasi hapsirat e vjetra të kësaj zone janë të përmasave të vogla dhe nuk krijojnë probleme. Nga ana tjetër ndikimi në strukturën e nëntokës është lidhur direkt me volumin e prodhimit. Për arsye sigurie gjatë fazës së shfrytëzimit do të merren të gjitha masat teknike dhe organizative për forcimin e galerive dhe parandalimin e shëmbjeve. Sa i takon sipërfaqes së tokës do të ketë ndikime nga proceset mekanike të depozitimit dhe transportit të mineralit. Si rezultat i shpëlarjes së masës minerare të depozituar në qiell të hapur mund të kemi zhvendosje të grimcave minerare përgjatë shpateve të pjerrët të zonës minerare për në trupat ujore stinore. Për parandalimin e efekteve të shpëlarjes së shiut duhet të ndërtohet një kanal perimetrik përreth sipërfaqes së dampës së depozitimit të mineralit. Ndikime të tjera në sipërfaqen e tokës të lidhura me këtë fazë janë ngjeshja e tokës nga lëvizja e makinerive, erozioni i tokës përreth zonës së hapjes së galerisë dhe përgjatë rrugëve në zonë, ndotja e tokës nga lubrifikantët e makinerive

Ndikimet e mundshme negative në ajër

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Megjithëse ndikimet e mëdha negative në ajër të sektorit minerar lidhen më shumë me proceset e përpunimit dhe shkrirjes së mineraleve ose gjatë fazës së shfrytëzimit me karriera sipërfaqësore, disa lloje ndikimesh evidentohen gjatë transportit të mineralit. Pluhuri dhe gazet - proceset që mund të shkaktojnë pluhura në mjedis janë ventilimi i galerive nëntokësore dhe transporti i mineralit. Agjentët atmosferikë si era mund të ngrenë sasi të konsiderueshme pluhuri nga kantieret e minierave prandaj në mot të thatë dhe me re nevojitet të lagen sipërfaqet e dampave si dhe minerali i depozituar aty (kjo në varësi edhe të ekspozimit të dampës ndaj qendrave të banuara). Mënjanimi i pluhurave do të realizohet nëpërmjet spërkatjes së vendit të punës me ujë nga kanali. Gjatë operacioneve të punës do të shpohen vrma me çekiç pneumatik me goditje-rrrotullim, duke krijuar sasi të konsiderueshme pluhuri, për mënjanimin e të cilit do të aplikohet shpimi me lagje. Për këtë qëllim, në hyrjen e ajrit të komprimuar do të vendoset një bombul uji, me saraçineskë 1/2", e cila do të ketë dalje në çekiçin pneumatik. Kështu uji do të futet së bashku me ajrin e komprimuar dhe do të dalë bashkë me të duke bërë të mundur eliminimin e pluhurit gjatë procesit të shpimit. Kjo është teknikë e përdorur edhe më parë në këtë minierë kështu që aplikimi i saj s' do të paraqesë probleme. Në frontet ku kjo metodë nuk mund të përdoret, largimi i pluhurave nga fronti do të kryhet me anë të intensifikimit të ajrit. Gjatë punimeve nëntokë dhe shpërthimeve krijohen gaze si CO_x dhe NO_x të cilët mund të kenë efekte negative dhe me pasojë sidomos në jetën e minatorëve. Megjithëse nuk parashikohen çlirime të mëdha gazesh nga operacionet nëntokë, megjithatë sistemi i aspirimit dhe ventilimit të gazeve dhe pluhurave duhet të funksionojë rregullisht. Zhurma dhe vibracionet - Makinat e rënda dhe eksplozivët që do të përdoren gjatë shfrytëzimit do të çlirohen zhurma në mjedis. Kompania do të marrë masat që vlerat maksimale dhe minimale të jenë brenda limiteve të vendosura nga Udhezimi Nr 8.

Sa i takon efekteve të shpërthimit nëntokësor, nuk vlerësohet të kenë ndikime thelbësore së pari sepse janë operacione që kryhen nëntokë dhe së dyti sepse qendrat e banuara janë larg.

Ndikimi në biodiversitet

Siç është vënë në dukje edhe në seksionet dhe paragrafët e mësipërm, zona karakterizohet nga bimësi relativisht e rrallë, për pasojë kur flasim për ndikime në biodiversitet do të marrim në konsideratë ndikimet në faunë. Në këtë rast ndikimet që do të shfaqen janë shqetësim i llojeve të ndryshëm që popullojnë zonën për shkak të zhurmave dhe pluhurit. Por duke patur parasysh që zhurmat dhe pluhuri parashikohet të jenë në vlera brenda normave të lejura edhe shqetësimi i faunës do të jetë minimal. Sa i takon ndikimeve në ujëra, duhet theksuar se nga projekti teknik dhe mënyra e propozuar për shfrytëzim, vërehet se nuk do të ketë përdorim

të shumtë të ujit, vetem I nevojshëm për aktivitetin njerëzor në sipërfaqe. Në këto kushte nuk do të ketë ndikime negative në mjedis pasi mungojnë shkarkimet e ujrave të ndotur.

VII. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

Ndikimet ne toke dhe masat parandaluese

Impakti: Aktiviteti mineral e cenon zonen nepermjet gerryerjes ne karriere dhe sheshet e hapjes se grykave te punimeve minerare kapitale dhe si rrjedhim ndikimet ne toke do te jene te konsiderueshme. Perdorimi i tokes konsiston ne shfrytezim afatgjate te saj si shesh ipunimeve te minieres, por edhe zenien e saj ndonese ne siperf aqe te vogla per depozitimin e perkohshem te shtreses se humusit dhe depozitimet e sterileve. Zona ndodhet ne nje terren shkembor me pjenesi mesatare dhe kryesisht me bimesi te pasur. Ne lidhje me efektin e erozionit per skarpatet e trasese se rruges verne ne dukje se projekti do te ndikojte ndjeshem pasi eshte tenen i pjerret.

Masat parandaluese: Per shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapshire i siperfaqes qe itakon ndertimit te minieres. Ne zonen e shfrytezirnit mineral te zones, hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit parashikohet mbushja, sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i siperfaqeve te germuara apo qe do te demtohen nga depozitimi i sterileve dhe mineralit. Rahabilitimi i siperfaqeve sa me shpejt te jete e mundur per te mos humbur siperfaqe toke. Gjate ushtrimit te aktivitetit dhe kryesisht ne vitet e fundit te tij, parashikohet trajtimi i te gjithe siperfaqes qe I perket karrierave, rrugeve dhe shesheve te depozitimit .Kjo siperfaqe e perfituar nga trajtimet e mesiperme do te jape mundesi minimale per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjitheshme te zones. Mbjellje e bimesise autoktone per te ruajtur strukturen dhe perberjen natyrale te tokes.

Ndikimet ne ajer (cilesia e ajrit, zhurmat, vibrimet, peizazhi) dhe masat parandaluese

Impakti: Hapja dhe perdorimi i rrugeve do te shkaktoje ndikim ne cilesine e ajrit, do te ngrihen pluhura gjate trasese se rruges dhe ne sheshin e punimeve dhe ne rast se nuk aplikohet lagia me uje gjate sezonit me thatesire. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkirneve te gazeve te demshme per

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

ajrin. Perdorimi I lendeve plasese, per te cilat jane dhene shpjegime, do te jete nje tjetër burim i pluhurit dhe lendeve te tjera te ngurta ne ajer. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga shperthimet e masivit te shkernbit, nga transporti, germimet e tokes shkembore, etj. vibrimet do te jene prezente vetem gjate procesit tv perdorimit te lendeve plasese per shkeputjen e masivit. Ndikimi i tyre varet edhe nga drejtuesi teknik, i cili duhet te ruaje nivelin e perdorimit te lendeve plasese. Gjate punimeve do te kete demtim te peizazhit te zones, nga gerrnimet dhe humbja e bimesise, ndryshimi i relievit, depozitimi i sterileve, ndertimi i perkohshem i objekteve dhe magazinim i materialeve ndertimore.

Masat parandaluese: Aplikimi i lagies se trasese se kantierit me uje gjate sezonit me thatesire per te reduktuar pluhurat. Kufizimi i orarit te punes vetem gjate dites per te reduktuar zhurmat. Perdorimi i mjeteve bashkekohore dhe me kriter e brenda kushteve teknike. Perdorimi i mjeteve dhe materialeve cilesore e eficiente. Monitorim i cilesise se ajrit gjate fazes se punimeve. Menaxhim i sterileve te depozituara dhe te sheshit te grumbullimit. Ky projekt ndikon ne permassa te konsiderueshme ne mjedisin biologjik te zones. Kete efekt mund ta reduktoje vetem zbatimi i nje projekti rehabilitimi te detajuar te siperfaqes se shfrytezuar te karrieres.

Ndikimet ne ujera dhe masat parandaluese

Impakti: Projekti nuk do te kete ndikime ne modelin drenazhues te tokes pasi nuk prek sisteme te ndryshme te ndertuara ose projektuara drenazhimi. Ushtrimi i ketij aktiviteti, ne kushte optimale dhe perfundimi i veprimtarise ne objekt, nuk do te ndikojë ne nivelin e ujrave tokesore, ne rruget ujore dhe ne rrjedhen e ujrave nentokesore. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka burime ujore nentokesore dhe shpime te ndryshme te karakterit hidrogjeologjik.

Masat parandaluese: Te orientohen ujerat e shiut, duke mos krijuar erozion dhe te mos krijohen pellgje uji ne mjedisin e karrieres. Te orientohen uje nentokesore qe mund te dalin ne siperfaqe gjate germimeve, duke mos lejuar rrjedhjen e tyre ne menyre te pakontrolluar ne mjedisin e zones. Makinerite te mos shkarkojne substanca te demshme ne mjedisin ujqor te zones.

Ndikimet ne biodiversitet dhe masat parandaluese

Impakti: Ndikimi kryesor dhe me i rendesishem ne mjedisin biologjik eshte gjate fazes se punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e minieres. Nga zbatimi i ketij projekti qe ne total perfshin nje siperfaqe prej 0.479 km², pritet nje efekt domethenes ne demtimin e bimesise se zones, ndonese nuk dallohet si zone me bimesi te larte, por kryesisht ate shkurre e barishtore. Demtimi i siperfaqes se tokes dhe i shtreses bimore, te cilat sherbejne si habitat per nje sere gjallesash do te

Nderveprimi me mjedisin Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

ndikonte edhe ne largimin e faunes se zones. Kryesisht kafshet e egra, zogjte dhe insektet e zvarraniket. Ndikimi i zhurmave do te ndikojte edhe ne largimin e faunes ne nje rreze disa qindra metra ose edhe ne km, kjo kryesisht nga aktiviteti I perdorimit te lendeve plasese per perdorim civil, qe sherbejne per shkeputjen e masivit shkembor. Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekeshme nga efektet e shfrytezimit per arsye se aktiviteti i ri aplikohet ne objekte qe kane gene edhe me pare efektiv, pra pergjithesisht mund te themi se nuk demtohet flare e faune ne lloj e ne numer. Perkundrazi, gjate aktivitetit te shf rytezimit dhe mbas tij krijohen kushte te pershtatshme per zhvillimin e flares e faunes ne kete zone nga masat rehabilituse te parashikuara. Ne zonen e kerkuar per shfrytezim nuk ka bime ujore. Zona eshte ne terren kodrinor malor ne formacione te forta shkembore dhe ne kushte te papershtatshme per bime ujore. Ky aktivitet nuk do te kete demtime te tyre dhe rrjedhimisht as masa mbrojtese per to

Masat parandaluese: Rehabilitimi sa me pare i skarpatave dhe siperfaqeve pyjore te demtuara dhe investimi ne ndertimin e pritave per reduktimin e erozionit. Zbatimi i projektit te rehabilitimit sipas preventivit te detajuar te punimeve rehabilituese dhe monitorimi i ecurise se ketij procesi ne vazhdimesi. Mirembajta dhe monitorim te vazhdueshem te terrenit problematik edhe nga erozioni natyror ne segmente te caktuara. Mbjellja e bimesise autoktone dhe sipas skemes se projektuar per te ndikuar ndjeshem ne uljen e erozionit dhe ne ruajtjen e identitetit te bimesise se zones. Si rrjedhoje edhe rikthimin e faunes autoktone te larguar perkohesisht.

Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik dhe masat parandaluese

Impakti: Ndikimi ne mjedisin social-kulturor e ekonomik nga faza e zbatimit te punimeve te shfrytezimit te mineraleve, vleresohet te jete pozitive. Kjo per shkak te nivelit te ulet ekonomik te zones dhe rritjes se punesimit nga projekti shfrytezimit, por edhe te tradites se zones, banoret e te ciles kane punuar prej vitesh ne miniera. Investitori do te kryeje edhe disa punime te tjera si hapje rruge dhe mirembajtje te rruges ekzistuese. Zbatimit i projektit te shfrytezimit nuk ka dhe nuk do te kete impakt negativ, as afatshkurter dhe as afatgjate mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne zone dhe perreth saj nuk ka objekte te nje rendesie te vecante te karaktereve te mesiperme. Investim i tille, ndikon ne zhvillimin ekonomik e social-kulturor te zones. Perdorimi I tokes aktualisht eshte per blegtori, nuk perfshihen taka bujqesore. Persa i perket burimeve ujore, nuk perdoren per kete veprimtari. Nga burimet e zones, dote krijohet mundesia e fumizimit me uje per plotesimin e nevojave te punetoreve dhe te ambienteve te punes.

Masat parandaluese: Aktiviteti qe do te kryhet nuk ndikon ne infrastrukturen aktuale, mbasi ne zone mungojne transporte te rendesishme. Aktiviteti i

Nderveprimi me mjedisin **Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”**

shfrytezimit jep kontribut ne rritjen e efektivitetit te rruges nga objekti deri ne qytetin e Bulqizes. Gjate ushtrimit te aktivitetit ne objektin e shfrytezimit subjekti do te mbaje parasysh qe problemet e shendetit te punonjesve, sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me impakte sociale te mprehta, qe kerkojne vleresim serioz. Plotesimi i kerkesave te komunitetit, ruajtja dhe mirembajtja e infrastruktures rrugore te zones, punesimi i komunitetit te zones, rritja e investimeve ne sektore te ndryshem dhe kontributi ne taksat vendore. Krijimi i kushteve te mira te punes, siguri ne pune dhe zbatimi i kushteve teknike duke investuar ne hapjen dhe mirembajtjen e minieres. Gjate ushtrimit te aktivitetit ne objektin e shfrytezimit subjekti do te mbaje parasysh qe problemet e shendetit te punonjesve, sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me impakte sociale te mprehta, qe kerkojne vleresim serioz. Para se gjithash, ne te gjitha operacionet do te drejtohet me specialiste te kualifikuar teknikisht dhe proceset dote kontrollohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar e te BE.

Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike (ndryshimi i klimes, emetimi i

substancave ozon-holluese)

Impakti: Projekti ne vleresim nuk dote perfshije substanca te tilla qe mund te ndikojne ne rritjen e perqendrimit te lendeve ozon-holluese ne atmosfere. Nuk do te kete shkarkime te lendeve helmuese apo kimikateve te rrezikshme. Vleresohet vetem lenda djegese e mjeteve te renda te punimeve te germimit, megjithese ne nivele te uleta. Faktor tjetër negativ mund te vleresohet reduktirni i bimesise se zones dhe pakesimi i filtrimit.

Masat parandaluese: Rekomandojme rehabilitimin e mjedisit te demtuar dhe mbjelljen e pemeve ne raport 1 me 3.

Ndikimet nderkufitare

Projekti ne vleresim nuk prek mjedisin kufitar. Nuk ben pjese ne projektet me ndikim nderkufitar, shfrytezim te ujerave nderkombetare dhe projekte te Sigurise se Digave, pasi ky projekt dote jete ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk perdor burime ujore. Siperfaqja e demtuar nga zbatimi i ketij projekti, mund te rehabilitohet dhe te ripyllezohet ne pjesen mete madhe te saj, pothuajse ne masen 100% te siperfaqes.

Menaxhimi imbetjeve te ngurta

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Nga punimet e zbatimit eshte vleresuar nje sasi e madhe sterilesh, te cilat kane nevojte te menaxhohen per te mos u shnderruar ne nje problem mjedisor. Nuk do te ndertohet landfill per depozitim inertesh, ato do te sistemohen ne nje siperfaqe brenda sheshit te miratuar, pjerresite e faqeve malore ku zhvillon aktivitetin miniera, te cilat jane faqe pa bimesi dhe qe nuk krijohen probleme. Ne perfundimin e aktivitetit siperfaqja e minieres do te pyllzohet me bimesi endemike. Edhe sheshi i ndertimit te objekteve siperfaqesore pas perfundimit te operacionit te shfrytezimit do te perpunohe dhe pyllzohet.

VIII. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA

Ndikimet e mundeshme nga ky aktivitet si emetimet e zhurmave, mbetjeve, pluhurave, gazeve, ujerave teknologjike do te monitorohen ne vijimesi per menaxhimin korrekt te aspekteve mjedisore. Theksojme ndikimet jane minimale.

Ndikimet ne mjedis sado minimale qe jane do te zgjasin per sa kohe qe zhvillohet edhe aktiviteti. Keto ndikime varen edhe nga sasia dhe oret e punes ne dite, apo ne muaj. Kjo ne varesi te kerkeses se tregut huaj dhe vendas

IX. T E DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Ndikimet e mundeshme qe mund te rezultojne nga ky aktivitet jane te karakterit lokal dhe nuk shtrihen ne zona te tjera perreth aktivitetit. Sikurse eshte shpjeguar ne paragrafin e ndikimeve dhe masave zbutese ndikimet jane minimale dhe jo te rendesishme ne kontekstin rajonal apo nderkufitar.

X. REHABILITIMIT I MJEDISIT TE NDIKUAR

Plani perfundimtar i mbylljes dhe rehabilitimit mjedisor pas perfundimit te aktivitetit minerar te shfrytezimit te kromit ne zonen minerar te lejes se

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

shfrytezimit 1855, date 27.04.2018, objekti Letaj Fushe Lope rrethi Bulqize Qarku Diber hartohet ne zbatim te Udhezimit Nr 718, date 03.10.2011 “ Per menyren e vleresimit te garancive financiare te lejeve minerare”

Aneksi 4 “ Menyra e vleresimit te garancive per realizimin e e planit te rehabilitimit per lejet minerare e shfrytezimit dhe kerkim-zbulim shfrytezimit”

Pika 2 Per shfrytezimin siperafaqesor, nenpika b Preventivi tip i planit te rehabilitimit te nje 1 ha kariere per grupin e materialeve te ndertimit .

Ky plan perfundimtar mbyllje dhe rehabilitimi ka per qellim marrjen ne konsiderate te gjendjes perfundimtar te parashikuar ne projekt dhe shqyrtimindhe parashikimin e shpenzimeve te domosdoshme per mbylljen dhe rehabilitimin e pas shfrytezimit te te kromit ne zonen minerar te lejes se shfrytezimit 1855, date 27.04.2018, objekti Letaj Fushe Lope rrethi Bulqize Qarku Diber “DELIU 3D "sh.p.k

Ne tabelat e meposhteme jane dhene llogaritje perkatese per realizimin ete gjitha proceseve perkatese te parashikuar ne preventivin tip:

1. Shpenzimet per kryerjen e proceseve perkatese per mbylljen trajtimin e sterileve dhe rehabilitimin e siperafaqes se tyre prej 0.93 ha jane 558070 leke
2. Siperfaqja e pergjithshme horizontale e rrugeve te karrieres, qe do te trajtohet eshte 0.04ha dhe shpenzimet per rehabilitimin e saj rezultojne 24003 leke
3. Shpenzimet per kryerjen e proceseve perkatese per mbylljen trajtimin dhe rehabilitimin e siperafaqes se shfrytezimit prej 1.69 ha jane 1014127 leke
4. Shpenzime per mbylljen e 4 punimeve minerare 826084 leke
5. Shuma e pergjitheshme per mbylljen edhe rehabilitimin e karrieres 2422284 lek
6. Paguar vitin pare 41466 leke
7. Shuma e pergjitheshme per tu paguar 2380818 leke
8. Garancia vjetore e rehabilitimit do te jete 99200 leke /vit
9. Shuma e mesiperme eshte parashikuar ne shpenzimet e subjektit dhe eshte marre ne konsiderate ne llogaritje e te ardhurave dhe shpenzimeve me CF.

Te dhenat qe do te perftohen nga monitorimi i parametrave mjedisore, qe jane te percaktuara me te detajuara ne Lejen e Mjedisit edhe ne do te sherbejne per te:

- Permiresuar dhe rikorrigjuar masat qe do te merren per mbrojtjen e mjedisit;
- Per te vleresuar efektivitetin e masave qe do te marren per kontrollin e ndikimeve dhe mbrojtjen e mjedisit (performance mjedisore);

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Per te vleresuar perputhshmerine me kerkesat e legjislacionit mjedisor per mbrojtjen e mjedisit.

XI. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masa zbutese te ndikimeve te mundshme negative ne mjedis

. Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në tokë

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te hapjes se rruges se re, punimit te hapjes dhe te rikonstruksionit te punimeve ekzistuese	Gjenerim i nje sasive te vogel dheu e cila mund te sistemohet pergjate rruges dhe te perdoret ne fazen e fundit per qellime mbushjeje dhe rehabilitimi
2	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te rikonstruksionit dhe atyre te reja do te limitohet brenda siperfaqes se kerkuar
3	Erozion minimal ne kohe me rreshje ne sheshet e punes	Pjerrësia e terrenit behet shkak qe tokes te ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenjte
4	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit jo te madh te punimeve
5	Vibracion germimeve dhe nga makinerite	Gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në ajër

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
--	---------------------------	-------------------------

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Sasia shkarkohet
2	Emetim automjetet	Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijoje probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara
3	Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit	Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesoj kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shqetesim i faunes ne zone	Siperfaqja ku do te kryhen punimet per hapjen e rruges dhe punimet e shfrytezimit eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Fakti qe ne zone ka zhvillohen shume aktivitete te ngjashme, na jep te drejte te themi se nuk do te kemi ndonje shtim apo demtim habitati e ekosistemesh te virgjera. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në pejsazh

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
--	--------------------	------------------

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

1	Ndikime Topografine e	Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime te pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te pejsazhit. Gjithashtu ndikime do te kete edhe ne zhvillimin e proceseve te tokeformimit etj. ne siperfaqen
---	--------------------------	--

Mbetjet e ngurta

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Gjenerim I mbetjeve aktiviteti njerezor	Kartona, bidona vaji, Plastike nga punonjesve

XII. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR

Konventa “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Konventa ESPOO)” ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve qe zhvillohen kryesisht ne zona nderkufitare dhe qe mendohet qe mund te kene ndikim ne mjedisin e vendeve fqinje. Shqiperia eshte pale ne kete Konvente qe prej 4 Tetorit te vitit 1991. Kjo Konvente synon bashkepunimin midis shteteve per mbrojtjen e mjedisit nderkufitar nga projektet me ndikim ne mjedis nepermjet:

- N
jofimit paraprak te shtetit, mjedisi i te cilit mund te ndikohet nga nje projekt i caktuar. Njoftimi behet nga Shteti, i cili synon te zbatoje projektin ne territorin e tij, i cili e fton Shtetin qe mund te ndikohet te marre pjese ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar, duke i dhene kohe te mjaftueshme dhe vene ne disponim raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar;
- D
uke e njoftuar Shtetin e ndikuar per vendimin perfundimtar per projektin

Nderveprimi me mjedisin **Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”**

dhe kushtet per mbrojtjen e mjedisit qe duhet te respektohen.

Gjthashtu nga Shqiperia jane ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nepermjet Ligjit Nr. 9478, date 16.02.2006 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventes se ESPOO-s "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne kontekst nderkufitar”.

Subjekt i kesaj konvente jane te gjitha projektet e listuara ne shtojcen I te kesaj Konvente, ose me sakte ne Amnedamentin e dyte te kesaj Konvente, ku jane listuar te gjitha projektet qe i nenshtrohen kerkesave te kesaj konvente.

Projekti i propozuar nuk ben pjese ne shtojcen 1 te kesaj konvente dhe mbi te gjitha nuk do te ushtrohet ne nje territor kufitar.

XIII. PLANI I MENAXHIMITDHE PROGRAMI I MONITORIMIT TE MJEDISIT

Te pergjithshme

Ky seksion perfshin pershkrimin e Planit te Menaxhimit Mjedisor (PMM) te projektit. Qellimi kryesor i PMM, eshte te siguroje nje proces sa me pak te demshem per mjedisin nepermjet masave rehabilituese, te cilat do te minimizonin demtimin e mjedisit dhe rekuperimin e tij. PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do te jete ne formen e nje drafti ne menyre qe te siguroje implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe te parandaloje ndikimet e mundshme mjedisore te anashkaluar ne raportin e VNM-se. Pavaresisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat qe duhet te ndiqen gjate shfrytezimit te mineraleve.

Plani i menaxhimit te mjedisit te demtuar nga zbatimi i ketij projekti

Ky plan synon minimizimin e ndikimeve ne mjedis duke marre masa specifi.ke per secilin ndikim te pershkruara ne kete seksion do te vleresohet si pjese e procesit te zbatimit te projektit per te zbutur ndikimet e mundshme nga aktivitetet. Ne pararelizem per te permbushur komponentet e nenprojekteve kryesore te kerkuara

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

nga legjislacioni shqiptar te aspekteve flitedisore dhe sociale do te strukturohen sipas kuadrit perkates ligjor. Masat lehtesuese kryesore do te perfshihen, por nuk do te limitohen ne kete pike, pasi gjate punimeve round te kete ndryshime dhe probleme qe round te shoqerohen me ndikim ne mjedis.

Nder te tjera eshte projektuar qe te kihet parasysh nga investitori:

- Perzgjedhja optimale e kapaciteteve dhe e menyres se shfrytezimit.
 - Parandalimi i krijimit te trafikut ne zone;
 - Demtimi i mjedisit pyjor ne minimumin e lejueshem
 - Masat per reduktimin e pluhurave nga punimet
 - Masat per reduktimin e zhurmes;
 - Masa per rehabilitimin e siperfaqeve te demtuara duke minimizuar erozionin.
- Kjo duke zbatuar me perpiktmeri projektin e rehabilitimit te mjedisit te hartuar qe ne fazen para fillimit te punimeve.
- Respektimin e kushteve te lejes/deklarates se leshuar nga Ministria.
 - Monitorim te treguesve mjedisore gjate punimeve.

Monitorimi i mjedisit

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes dhe mjedisit biologjik, kryhet sipas disa

kritereve shkencore persa i perket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te sigmuar informacione mbi Hdhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjedisive ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhirnin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat (C1,

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

C2, , C6,C7, C8 te Vendimit Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise"

Investitori dote monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis vetem gjate fazes se punimeve dhe funksionimit

- Per ajrin duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull (LNP, PM10) dhe zhurmat (dB).
- Per ujin,

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet ne aktin e miratimit te lejes se mjedisit dhe do tye, dorezohet nje relacion periodik ne AKM.

Plani i monitorimit ne mjedis

Me qene se kemi te bejme me shfrytezimin e mineralit te kromit ne siperfaqe te shpatit te malit ku ndodhet objekti, si dhe ne thellesi te nentokes nevojitet nje monitorim i vazhdushem jo vetem ne siperfaqen e objektit qe do te shfrytezohet, por edhe ne nje zone mbi 300 m perreth.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- Monitorimin e sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te minieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundshme si shkarje, shembje ose vidhisje te tokes.
- Monitorimin e parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij.
- Monitorimin e sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen perreth objektit dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre.
- Monitorimin e siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gerryerjeve, krijimin e gropave, etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimin e siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirrrjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i cdo siperfaqeje te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe kohe, gjate se ciles bimet kane marre nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojte per sherbime.

Masat per rigjenerimin e mjedisit

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te objektit konsistojne ne:

- Krijimin e siperfaqeve per mbjellje.
- Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e zones se shfrytezimit dhe ne afersi te hyrjeve te punimeve;
- Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane pishe dhe barishte te ndryshme;
- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella

Shoqeria merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjencine Kombetare te Mjedisit, Agjencine Rajonale te Mjedisit, prane se ciles do te informoje periodikisht per mbarevajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per monitorimin e parametrave te me mesiperme.

Rregullat e sigurimit teknik ne frontet e punes

Gjate punes ne miniere projekti parashikon zbatimin me rigorozitet te rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune.

Me poshte jepen drejtimet kryesore te mbrojtjes ne pune. Me te detajuara ato do t'u behen te ditura punonjesve nga drejtuesi teknik i punimeve ose nga i ngarkuari me sigurimin teknik.

Frontet e punes ne miniere, duhet te ndricohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ose burim te pavarur nga ndricimi individual i punonjesve.

Ndalohet qendrimi i punonjesve ne fronte te ndaluara dhe levizja ne to.

- Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, kur ato jane duke punuar.
- Ndalohet likuidimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje.
- Kur konstatohet se nga tavani i punimeve ka rreshqitje masive shkemi dhe ne rastet kur ka zona te dobesuara nga tektonikat, ndalohen punimet dhe kerkohet nga drejtuesi teknik te hartohet pasaporte pune e sigurte.

Ne cdo turn, para se te fillohet nga puna, behet kontrolli i frontit te punes, rrezimi i copave te gureve nga faqet e tavanit, kontrolli per mina te paplasura,

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit "Fushe Lope"

gjendja teknike e makinerive, etj.

Kur konstatohet se nga skarpatet e shkalleve ka rreshqitje masive dhe ne raste kur ka shira dhe furtune, ndalohen punimet dhe njerezit dhe mjetet largohen ne vende te sigurta.

Sigurimi teknik ne proceset e punes per hapjen, shfrytezimin dhe administrimin e objektit

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar subjekti duhet te mbaje parasysh, qe problemet e sigurimit tek.nik dhe te mbrojtjes ne pune jane mete rendesishmet, me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

Para se gjithash megjithese kemi te bejme me operacione minerare si pune me martel per shpim birash ne karriere dhe ne nentoke, ngarkim me ekskavator, ngarkim vagonash me lopate, armatim punimesh horizontale dhe te pjerreta me lende druri, transport me automjete ne karrire dhe

nentoke me vagona deri 0.6 m³ ne distance te konsiderueshme etj., ne te gjitha operacionet do te punesohen specialiste me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te ndryshme te karakterit minerar, dhe duhet te kualifikohen e rikualifikohen ne menyre te vazhdueshme.

Problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe kerkojne vleresim serioz, duke patur prasysh qe shfrytezimi me punime nentokesore eshte nje proces teknik dhe teknologjik me i veshtire se shfrytezimi me karriere.

Te behet instruktimi i rregullt i tyre dhe rikualifikimi fillestar e periodik, te drejtohen nga person i kualifikuar teknik dhe te kontrollohet mbarevajtja teknike e operacioneve dhe e veprimeve te punonjesve ne perputhje me rregulloret e miratuara nga Ministria.

Drejtuesi teknik i punimeve para fillimit te punes do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karrierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr. 132, date 07.04.1999, mbeshtetur ne ligjin Minerar Shqiptar Nr.10304, date 15.07.2010 "Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqiperise" dhe gjithë aktet e tjera normative te nxjerra per keto ceshtje.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

Drejtuesi teknik i karrieres, duhet t'u bejne te ditur punonjesve:

- Procesin teknologjik te operacioneve ne teresi ne karriere dhe te punes ne frontin ku punon.

Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne kantier.

Shkaqet e aksidenteve dhe masat per menjanimin e tyre.

- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune, aktet nenligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre te leshuar nga dikasteret qe lidhen me to.
- Vecorite e punes ne karriere ku do te punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes per menjanimin e aksidenteve.

Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen cdo punonjes, per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere qe punojne ne karriere ose te vizitoreve.

- Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne karriere pe t'u mbrojtur nga renia e copave te shkembinjve, punet me lende plasese, makinerite, rrymat elektrike, shkarkesat atmosferike etj.

Ndihmen e pare shendetesore.

- Vendosja ne territorin e karrieres dhe ne territorin e hyrjes se saj, ne vende te dukshme ditën dhe naten me pjeset kryesore te Rregullores se Sigurimit Teknik.

Te krijoje punonjesve kushte te mira pune dhe mjete mbrojtese.

- Te beje instruktimin paraprak dhe periodik te punonjesve, dokumentat sipas formularit te percaktuar ne Rregulloren e Sigurimit Teknik.

Rregullorja e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit, do te zbatohet ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga ai dhe te miratuar nga drejtuesit e shoqerise.

Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;

- Plan organizimi i punimeve dhe pasaportat teknike te punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do te beje kontrollin

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

teknik dhe azhornimin e sakte te punimeve minerare te cdo lloji, per te cilat subjekti ka marre leje minerare;

- Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohet nga administratori i shoqerise;
- Ne kete plan tekniko-organizativ masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor;
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore, ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet;
- Punonjesit qe do te punojne ne miniere per berjen e minave, kontrollin e tavanit te punimeve, arrnatimin e galerive, frontin e ngarkimit, rrugeve te transportit dhe zjarretaret direkt ose te nenkontruar dote testohen do tremujor kundrejt firmes.
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes, pastrimit te punimeve, rrugeve te transportit, krefjes se mureve te tavanit te vendit te pune dhe transportit etj.
- Do te zbatohet nje rregjim i rrepte ne zbatimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese te rrezimit te sterilite a mineralit dhe kryerjes se punimeve ne miniere, te hartuara praprakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit.
- Do te zbatohet nje rregjim i rrepte ne zbatimin e pasaportave teknike te punimeve te transportit te brendshem.
- Do te zbatohet nje rregjim i rrepte ne zbatimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese, gjate kryerjes se punimeve minerare qe do te sherbejne per rrezimin e shkembit dhe mineralit.

Rregullat e sigurimit teknik ne punimet me lendet plasese

Punimet me lende plasese detyrimisht kryhen me projekte teknike dhe pasaporta te miratuara nga drejtuesi teknik i punimeve. Zbatimi i rregulloreve te sigurimit teknik per punet me lende plasese eshte domosdoshmeri per te menjanuar aksidentet ne pune. Pasaporta do te kryhet per cdo punim minierar qe do te kryhet ne karriere.

Pasaporta do te permbaje:

- Skemen e vendosjes se birave.
- Thellesine dhe kendin e pjerresise se tyre.
- Tipin e lendes plasese.
- Ngarkesen me lende plasese.

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

- Numrin e ngarkesave me lende plasese qe do te shperthehen njekoheesisht.
- Menyren e shperthimit te ngarkesave me lende plasese.
- Rradhen e shperthimit te ngarkesave me lende plasese.
- Logaritja e ngarkesave me lende plasese.
- Gjatesine e ngarkesave me lende plasese, kollona e taposjes, materiali taposes dhe menyra e ngjeshjes.
- Skemen e shperthirnit.
- Vendstrehimin e zjarrinvetarit.

Plani i likuidimit te avarise

Ketu parashikohet dhe u behet e qarte punonjesve, vetem me dhenien e ndihmes ne rastet e aksidenteve, per shkaqet e mundshme qe jane krehja e shpateve, ne transportin e mineralit dhe sterilit, si dhe per masat qe duhen te merren ne nentoke, ne frontet e punes ne transport etj, meqenese eshte edhe miniere nentokesore duhet te hartohet plan i vecante i likujdimit te avarive qe ka te beje me shpetimin e punonjesve.

Per vete natyren e objektit nuk ekziston rreziku i bllokimit nga shembja e punimit, zjarret, ujerat etj. Behet e ditur dhe qartesohet here pas here menyra e njoftimit te drejtuesve te shoqerise sipas nje skeme te percaktuar me pare, ku te jene shenuar menyra e njoftimit, per rastet e demtimit te shendetit te punonjesve dhe avarive te ndryshme.

Parashikohen masa per menyren e dhenies se ndihmes se shpejte, mbrojtjen nga zjarri. Per te dyja rastet duhet te kemi te kompletuar kutine e ndihmes se shpejte e duhen te jene instruktuar punonjesit se si jepet kjo ndihme e shpejte, si dhe ne rast zjarri ne siperaqe, duhet te jene gjithnje ne gadishmeri rnjetet zjarrfikes

XIV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nderveprimi me mjedisin

Vendburimi i mineralit te kromit "Fushe Lope"

Ne perfundim te ketij studimi arrijme te nxjerrim disa perfundime te rendesishme dhe disa rekomandime te nevojshme per te bere te mundur zbatimin e projektit me ndikime sa me te pakta ne mjedis nga shoqeria "DELIU 3D" Sh.p.k.

Konkluzione

Ky projekt ze nje siperfaqe te konsiderueshme dhe si e tille ka ndikime ne mjedis. Ne rast se do te zbatohen masat zbutese dhe rekomandimet e ketij raporti, keto ndikime vleresohet te reduktohen ne masen me te madhe te tyre.

Ky aktivitet shoqerohet me ndikime ne mjedisin e zones, por gjithashtu edhe me perfitime te medha ekonomike per rajonin dhe ne rang kombetar. Duke vleresuar perfitimet ekonomike dhe duke pasur ne konsiderate rehabilitimin e plote te siperfaqeve te demtuara, ky aktivitet mund te zhvillohet ne pajtueshmeri me mjedisin biologjik dhe ate human.

Rekomandime

Me qellim qe te kemi nje ndikim minimal ne mjedisin e zones ne teresi nga zbatimi i projektit, rekomandojme:

- Te perdoret sasia e dheut te gjeneruar nga germimet per te rehabilituar siperfaqet e demtuara, si dhe tepricat te depozitohen ne vende te caktuara nga komuna, ose te menaxhohen ne menyre te pa demshme per mjedisin.
- Te regjistrohen pemet e prera dhe te mbillen bimesi autoktone ne siperfaqet e demtuara pas sistemimit te tyre me dheun e germuar nga siperfaqja. (Sipas projektit te rehabilitimit ne raport 1 me 3
- Te rehabilitohet traseja e rruges se re qe do te hapet dhe e asaj ekzistuese ne pika delikate te saj nga amortizimi.
- Te aplikohet lagia e rrugeve dhe kantieri me qellim reduktimin e pluhurit.

Ujerat

e kantierit te orientohen me sistem kanalizimi ose dhe e shoqeruar me vaske dekantimi.

- Te respektohen kushtet dhe rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit ne zone pyjore.
- Te respektohen detyrimet dhe kushtet e vena ne lejen/deklaraten mjedisore nga

Ministria e pergjegjese Mjedisit.

- Te kryhet monitorimi periodik i aktivitetit gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se funksionimit te aktivitetit. Keto te dhena te monitorimit te

Nderveprimi me mjedisin
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”

dorezohen rregullisht prane Drejtorise Rajonale te Mjedisit .

- Te kryhet sa here te jete e kerkuar nga pushteti lokal apo banoret konsultimi me komunitetin e gjere dhe sqarime te paqartesive te tyre ne lidhje me kete aktivitet
- Zbatimi i projekti te zbatohet me perpikmeri dhe brenda siperfaqeve te paracaktuara, duke zbatuar edhe rregullat e sigurimit teknik dhe perdorim te rregullt te lendes plasese.
- Te mos anashkalohen detyrimet e sipermarresit per rehabilitimin e zones se demtuar dhe rrugeve te reja.

Hartoj Raportin nderveprimit me mjedisin

Enis CANI
“ESDO” Sh.p.k.

Ekspert i VNM dhe Auditimit Mjedisor

**Raport paraprak i Vleresimit te Ndikimi ne Mjedis
Vendburimi i mineralit te kromit “Fushe Lope”**
